

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK TË QYTETIT TË SHKUPIT, ME PLAN TË AKSIONIT

PËR PERIUDHËN 2018-2021



Shkup
korrik, 2018

Përmbajtja

Hyrje

1. Koncepti dhe metodologjia	5
1.1 Analiza e gjendjes ekzistuese	5
1.2 Definimi i prioriteteve, qëllimeve strategjike dhe masave	8
1.3 Ndjekja e statusit të realizimit të Strategjisë dhe planit të aksionit	11
1.4 Pjesëmarrësit në procesin.....	11
2. Parime për zhvillimin e qytetit të Shkupit.....	11
3. Aktivitete themelore të procesit të përgatitjes së Strategjisë dhe Planit të aksionit	12
4.Pasqyrë e aktiviteteve më të rëndësishme të realizuara.....	13
5. Gjendja ekzistuese e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit	15
5.1 Njësi të vetëqeverisjes lokale	16
5.2 Demografi biznesi dhe dinamikë biznesi.....	17
5.3 Analiza SWOT	18
6. Vizioni, misioni dhe qëllimet strategjike	23
6.1 Vizioni	23
6.2 Misioni i Strategjisë	23
6.3 Qëllimet strategjike:.....	24
7. Qëllimet strategjike	24
7.1 Qytet i mençur- modernizim i qytetit.....	24
7.1.1 Transporti publik i mençur.....	25
7.1.2 Ndriçimi rrugor i mençur	26
7.1.3 Ndjekja e mençur e cilësisë së ajrit	26
7.1.4 Menaxhim i mençur i mbeturinave.....	27
7.1.5 Zgjidhje e mençur për sigurinë publike	27
7.1.6 Menaxhimi i mençur i trafikut.....	28
7.1.7 Parkim i mençur.....	29
7.1.8 Mbushja e mençur e automjeteve elektrike.....	29
7.1.9 Zgjidhje e mençur për huazimin e biçikletave	30
7.1.10 Menaxhim i mençur i krizave	30

7.1.11 Tabelë e mençur e kontrollit të qytetit	30
7.2 Nxitja e zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë	31
7.3 Ambienti i volitshëm afarist	32
7.4 Përmirësimi i cilësive dhe funksioneve hapësinore të qytetit	33
7.5 Përmirësimi i cilësisë së jetesës së qytetarëve	35
7.6 Energjetika dhe efikasiteti energjetik	36
7.7 Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës	36
8. Implementimi, kontrolli, masat e korrëgjimit dhe revizioni i Strategjisë	38
9. Plani i aksionit	40
Aneksi 1 - Pjesëmarrësit në projekt	220
Dispozitat përfundimtare	223

Hyrje

Qyteti i Shkupit është qendra më e madhe administrative, kulturore, ekonomike, sportive dhe urbane në Republikën e Maqedonisë dhe si e tillë mundëson zhvillim të tërësishëm shoqëror, ekonomik dhe social dhe stil jetese dhe standard të përmirësuar bashkëkohor. Duke pasur paraqysh rëndësinë e Qytetit të Shkupit, si kryeqytet i shteti, si dhe vendosjen e tij organizative, bëhet përpunimi i Strategjisë për zhvillim lokal ekonomik për periudhën e viteve 2018-2021e cila është një mjet i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik të qytetit, e njëherësh, edhe të tërështetit. Qëllimi është përmirësimi i cilësisë së qytetit të Shkupit dhe afrimi i R. së Maqedonisë kah Bashkimi Evropian. Krahas zhvillimit ekonomik, për banorët e qytetit të Shkupit, rëndësi të veçantë ka zhvillimi edhe i zonave të tjera që janë në kompetencë të qytetit, e që e bëjnë qytetin të jetë vend funksional, efikas, efektiv dhe modern për të jetuar. Zhvillimi lokal ekonomik është proces me të cilin autoritetet lokale menaxhojnë në mënyrë efektive dhe efikase me resurset që i kanë në dispozicion dhe krijojnë kushte për t'u stimuluar aktiviteti ekonomik dhe për t'u hapur vende të reja pune.

Procesi i planifikimit strategjik ndihmon që të parashikohet zhvillimi i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytet në të ardhshmen. Fokusohet në çështjet me rëndësi kritike, mundësitë dhe problemet me të cilat ndeshen qyteti dhe njësitet e vetëqeverisjes lokale. Jep mundësi për një analizë më reale të problemeve të përditshme dhe ndihmon për t'u zbuluar dhe për t'u gjetur zgjidhjet e vërteta.

Përcaktohen përparësitë dhe qëllimet të cilat konsiderohen si më të rëndësishme, definojnë programet, projektet dhe aktivitetet, përmes të cilave realizohen përparësitë e definuara.

E gjithë kjo bëhet me qëllim të arritjes së vizionit për ardhmërinë e qytetit. Planifikimi strategjik është proces i vazhdueshëm dhe shërben për përcaktimin e përparësive të zhvillimit të Qytetit të Shkupit. Ai është një proces proaktiv, nëpërmjet të cilit, Qyteti i Shkupit dëshiron të përgatitet por edhe ta formësojë ardhmërinë e vet, duke iu përkushtuar çështjeve kritike strategjike dhe aktiviteteve me përparësi më të lartë.

Spektori i zhvillimit lokal ekonomik i kryen punët e planifikimit të zhvillimit lokal ekonomik, propozon përparësi zhvillimore dhe strukturore, në nivel të Qytetit të Shkupit, propozon masa dhe aktivitete për të udhëhequr politikën lokale ekonomike dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësinë, kujdeset për zhvillimin dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore, nga kompetenca e Qytetit të Shkupit, në sferën e zejtarisë, hotelërisë, turizmit dhe tregtisë, propozon masa për zhvillimin dhe nxitjen e turizmit alternativ dhe kulturor, propozon masa për

përmirësimin e kushteve të qëndrimit të turistëve në Qytetin e Shkupit dhe informimin turistik propagandues, e koordinon punën e vet me sektorët e tjerë në kuadër të administratës së qytetit.

Planifikimi strategjik është proces në të cilin përcaktohen përparësitë dhe qëllimet, të cilat konsiderohen si më të rëndësishme, me ç'rast definohen projekte dhe aktivitete, përmes të cilave, realizohen përparësitë e definuara dhe caktohen mjetet e nevojshme për realizimin e përparësive përmes procesit buxhetor. Në atë mënyrë realizohet vizioni për ardhmërinë e qytetit.

Vizioni për Qytetin e Shkupit është orientuar drejt konstruktimit të një qyteti të prosperitetshëm dhe të hapur, të njëjtë për të gjithë, qytet promotor i biznesit dhe qytet i dëshiruar për të investuar me ambient të volitshëm afarist. Qytet me ekonomi të qëndrueshme, të bazuar në dituri, inovacione dhe fuqi punëtore me kualifikim të lartë. Qytet me infrastrukturë dhe ndërtime të adaptuara për nevojat e qytetarëve, me shërbime cilësore për qytetarët që do ta radhisin Shkupin në vargun e metropoleve evropiane dhe qyteteve të mençura.

Në këtë mënyrë, qyteti i Shkupit do të jetë inkluziv, modern, i prosperitetshëm, qendër e fuqishme shoqërore dhe ekonomike dhe bashkësi sociale me standard të përmirësuar jetese për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme..

1. Koncepti dhe metodologjia

Metodologjia i definon fazat dhe procedurat në procesin e përgatitjes së Strategjisë për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit.

I përfshin kornizat kohore për realizimin e masave dhe aktiviteteve konkrete dhe e parashikon dinamikën e aktiviteteve përmes të cilave sigurohet realizimi i përparësive strategjike.

➤ Strategjia për zhvillimin lokal ekonomik të qytetit të Shkupit me Plan të aksionit për periudhën e viteve 2018-2021 bazohet në këta aktivitete:

- Analiza e gjendjes ekzistueseme përfaqësues të vetëqeverisjes lokale në territorin e Qytetit të Shkupit, odat dhe institucionet tjera për mbështetjen e NVM, me përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe të biznesit, me qëllim të përcaktimit të shkallës së realizimit të strategjisë së deritashme, me pasqyrë të mjeteve të planifikuara dhe të realizuara.

Analiza e gjendjes ekzistuese u bë përmes:


- **Anketës:**
- **Pyetësorëve anketues:**

- Intervistave dhe takimeve të drejtpërdrejta të punës me përfaqësues relevantë;
 - Analizës krahasuese të programeve (2014-2017) me projektet, përparësitë, qëllimet strategjike, dhe masat e realizuara.
- **Korniza normative** – akte, në bazë të të cilave është përgatitur Strategjia për ZHLE të Qytetit të Shkupit për vitet 2018-2021:
- Programi zgjedhor i prefektit të Qytetit të Shkupit,
 - Probleme dhe situata të identifikuara gjatë analizës së gjendjes ekzistuese në sferat që janë në kompetencë të Qytetit të Shkupit,
 - Programe sektorësh të aprovuara nga Këshilli i Qytetit të Shkupit për vitin 2018,
 - Plane strategjike dhe dokumente të Qytetit të Shkupit për periudhën e planifikimit, për veprimtari që janë në interes të qytetit (Strategjia për kulturë, Strategjia për të rinj, Strategjia për NVM, Strategjia për arsim, Strategjia për turizëm, Strategjia për efikasitet energjetik etj.).
 - Ligji për Qytetin e Shkupit
 - Ligji për vetëqeverisje lokale
 - Ligji për mbrojtje sociale
 - Ligji për ambient jetësor
 - Strategjia nacionale për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë 2009-2030
 - Plani strategjik për zhvillim rajonal të vetëqeverisjes lokale.
 - Strategjia evropiane për rritje ekonomike- Evropa 2020
 - Programi nacional për miratimin legjislativ të Bashkimit Evropian (NPAA) 2017 – 2019
 - Programi për zhvillimin e veprimtarisë për mbrojtjen e fëmijëve për vitin 2018
 - Plani strategjik 2016-2018
 - Strategjia për të rinjtë e Qytetit të Shkupit 2014 – 2018
 - Programi nacional për zhvillimin e mbrojtjes sociale 2011-2021
 - Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me invaliditet 2010-2018
 - Politika industriale e Republikës së Maqedonisë 2009-2020
 - Propozimi i Strategjisë për menaxhimin e mbeturinave të Republikës së Maqedonisë (viti 2008-2020)
 - Strategjia nacionale e punësimit në Republikën e Maqedonisë 2016-2020

- Strategjia nacionale për zvogëlimin e varfërisë dhe përjashtimit social në Republikën e Maqedonisë (2010-2020)
 - Strategjia për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020
 - Strategjia nacionale për personat e moshuar 2010-2020
 - Strategjia e zhvillimit rajonal të Republikës së Maqedonisë për vitet 2009-2019
 - European Commission action plan for 5G – 2025
- **Mbledhja dhe analiza e propozimeve për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit** –përmes përfshirjes së të gjithë palëve të interesuara relevante, me qëllim të përpunimit cilësor të Strategjisë dhe planit të aksionit, për çka është e domosdoshme të sigurohet përkushtueshmëri e të gjithë partnerëve – pjesëmarrës në këtë proces. Bashkëpunimi me partnerët e involvuar- pjesëmarrës, realizohet përmes organizimit të mbledhjeve punuese, takimeve dhe punëtoriveme qëllim që të fitohen informata të nevojshme dhe propozime për definimin e nevojave zhvillimore dhe potencialeve zhvillimore për zhvillimin lokal ekonomik.
- **Ndjekja e statusit të realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit**, përkatësisht realizimit të projekteve të planifikuara, sa i përket dinamikës së parashikuar. Rendësi e veçantë e progresit, drejt realizimit të aktiviteteve të planifikuara, është marrja e informatës kthyesë, në kohën e duhur, e përgjegjësve për realizimin e planit të aksionit dhe nevojat për harmonizime dhe ndryshime eventuale të Strategjisë dhe Planit të aksionit.

Realizimi i Strategjisë dhe planit të aksionit do të bazohen në modelin e bashkëpunimit afatgjatë, në të cilin koordinohen resurset e të gjithë partnerëve dhe resurset e Qytetit të Shkupit. Kjo duhet të rezultojë me përmirësim të vazhdueshëm të rezultateve në zhvillimin lokal ekonomik të qytetit.

Në vazhdim është dhënë pasqyra skematike e metodologjisë dhe procedura e përpunimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit për ZHLE.



NDJEKJA E STATUSIT TË REALIZIMIT TË STRATEGJISË DHE PLANIT TË AKSIONIT


- Analiza duhet të japë një pasqyrë të detajuar të zhvillimit lokal ekonomik dhe t'i vendos themelet e të kuptuarit të thellësishëm të gjendjes ekzistuese si dhe dinamikës së zhvillimit lokal, që lidhen me demografinë, faktorët shoqërorë, resurset natyrore, disponueshmërinë e infrastrukturës, cilësinë dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.
- Analiza përmban të dhëna sasiore dhe cilësore dhe parametra nga bazat adekuate të informatave (p.sh. Odat Ekonomike, LOE, Enti shtetëror i statistikës, ministri, njësi të vetëqeverisjes lokale etj.).
- Nga cilësia e të dhënave hyrëse do të varet edhe cilësia e vlerësimit të gjendjes për zhvillimin e NVM, që është bazë për përcaktimin e vizionit, qëllimeve, prioritetëve dhe masave.
- Nga vetë analiza perceptohen dhe përcaktohen:
 - Karakteristikat pozitive dhe negative;
 - Problemet e zhvillimit dhe nevojat e zhvillimit;
 - Indikatorët për zhvillim të nevojshëm të mëtejshëm.

Analiza e të dhënave do të orientohet kah ata sektorë të cilët janë përcaktuar si problematikë ose potencialë për zhvillimin.

1.2 Definimi i prioritetëve, qëllimeve strategjike dhe masave

Vizioni

Vizioni është një ide e qartë dhe e përcaktuar saktësisht për ndryshimet e dëshiruara për zhvillimin lokal ekonomik të qytetit. Ai është formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk është konkretizuar në mënyrë specifike, për një sektor të veçantë, por shpie në përparimin e përgjithshëm i cili duhet të arrihet.





Analiza SWOT është definim i nevojave dhe potencialeve të zhvillimit

- **Qëllimi i analizës SWOT** është që të sqarohet gjendja konkrete, përmes caktimit të hollësishëm të anëve të forta dhe të dobëta si dhe mundësive dhe kanosjeve për zhvillim të mëtejshëm.
- **Dobësitë dhe kanosjet** analizohen në kontekst të nevojave të zhvillimit, ndërsa **përparësitë dhe mundësitë**, në kontekst të potencialeve të zhvillimit.
- **Përparësitë** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet e NJVL¹ me mundësi më të mëdha për sukses.
- **Dobësitë** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet të cilat e përkufizojnë ose e pamundësojnë zhvillimin e NJVL.
- **Mundësi** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet jashtë entitetit, të cilat do të mund të shfrytëzohen për zhvillimin e NJVL (përparimin dhe përsosjen e përparësive dhe/ose zvogëlimin e dobësive).
- **Kanosje** – janë sektorët, resurset dhe kapacitetet jashtë entitetit të cilat mund ta rrezikojnë zhvillimin e NJVL (përmes zvogëlimit të përparësive dhe/ose theksimit dhe rritjes së dobësive).

Qëllimet strategjike

Si rezultat i analizës së gjendjes u definuan shtatë aspekte kyçe (shtylla), nga të cilat dolën këta qëllime strategjike:

1. Qytet i mençur – modernizimi i qytetit
2. Nxitja e zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë
3. Ambient i volitshëm afarist
4. Përmirësim i cilësive dhe funksioneve hapësinore të qytetit
5. Përmirësim i cilësisë së jetës dhe standardit të jetesës së qytetarëve

¹Njësi të vetëqeverisjes lokale

6. Energjetika dhe efikasiteti energjetik

7. Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës

Masat

Për çdo qëllim strategjik ishin zhvilluar masa konkrete, aktivitete dhe projekte, përmes realizimit të të cilave, duhet arritur qëllimet strategjike.

Përcaktimi i prioritetëve të projekteve të propozuara

Pas definimit të propozimprojekteve për secilin qëllim strategjik, filloi qasja drejt përcaktimit të prioritetit të masave dhe projekteve, në të cilat duhet të fokusohet Strategjia.

Përcaktimi i prioritetëve u realizua përmes vlerësimit të masave/projekteve të definuara nga pjesëmarrësit e punëtorëve të organizuara, sa u përket tre aspekteve:

1. Relevanca/arsyeshmëria e masës/projektit
2. Prioriteti i masës/projektit
3. Realizueshmëria (mundësitë) dhe Parakushtet për realizimin e masës/projektit

Duke e përmbledhur vlerësimin në lidhje me tre aspektet e para, u fitua një vlerësim përfundimtar prioritetesh për masat / projektet konkrete.

Në atë mënyrë u përcaktuan masat dhe projektet prioritare, në të cilat duhet fokusuar Strategjia, të cilat, para së gjithash, janë ndarë në disa sfera, në kuadër të Planit të aksionit, edhe atë:

- Projekte me rëndësi strategjike për zhvillimin e qytetit të Shkupit
- Ambienti jetësor
- Planifikimi hapësinor dhe urbanizmi
- Trafiku
- Efikasiteti energjetik
- Çështjet komunale
- Turizmi
- Zejtaria
- Arsimi
- Kultura

- TI dhe modernizimi

1.3 Ndjekja e statusit të realizimit të Strategjisë dhe planit të aksionit

Ndjekja e statusit të realizimit të Strategjisë dhe planit të aksionit do të realizohet përmes roleve dhe përgjegjëse, të përcaktuara dhe të definuara qartë, të bartësve dhe shfrytëzuesve të masave dhe aktiviteteve konkrete si dhe obligimi i tyre për dhënien e informimit kthyes, në kohë të duhur, të përgjegjësve për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të definuara si dhe nevojat për harmonizime dhe ndryshime eventuale të Strategjisë dhe Planit të aksionit.

1.4 Pjesëmarrësit në procesin

Bartës i procesit të përgatitjes dhe realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit për zhvillim lokal ekonomik, për periudhën e viteve 2018-2021 është Qyteti i Shkupit, përkatësisht Sektori për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit, me mbështetje të kompanisë Evrosimovski Konsalting.

Pjesëmarrës të përfshirë në mënyrë aktive gjatë përpunimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit ishin përfaqësuesit e emëruar nga institucionet e mëposhtme:

- Qyteti i Shkupit (sektorët relevantë)
- Komunitat në qytetin e Shkupit
- Shoqata, asociacione të NVM dhe oda të zejtarëve dhe ato ekonomike.
- Organizata joqeveritare
- Ministri dhe institucione të tjera publike

Lista e pjesëmarrësve është dhënë në shtojcën 1.

2. Parime për zhvillimin e qytetit të Shkupit

Zhvillimi i qëndrueshëm afatgjatë i qytetit të Shkupit duhet koncentruar në:

1. **Rritje e qëndrueshme-** Ngritje e nivelit të konkurrencës në sektorin publik dhe atë privat, zhvillim i infrastrukturës, qasje ekologjike dhe me efikasitet energjetik, zhvillim dhe përparim i kapaciteteve teknike, organizative dhe njerëzore të institucioneve në sferën e zhvillimit lokal ekonomik.
2. **Parimi i sundimit dhe qeverisjes së mirë-** Rritje dhe përmirësim i kapacitetit të administratës publike, mundësimi i sundimit të së drejtës, zvogëlimi i korrupsionit dhe partizimit dhe krijimi i kushteve për një klimë të volitshme dhe ambient i cili do ta nxisë efektivitetin dhe efikasitetin në të punuarit e bizneseve dhe do të

sigurojë shërbime publike të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e tërësishëm.

3. **Rritje inkluzive-** Theksimi i nevojës së zhvillimit të shtuar të shkathtësive, punësimeve dhe vetëpunësimeve, pjesëmarrjes inkluzive në tregun e fuqisë punëtore.
4. **Integrim dhe bashkëpunim i ndërsjellë** –model i bashkëpunimit të vazhdueshëm në të cilin koordinohen resurset e të gjithë partnerëve dhe resurset e Qytetit të Shkupit. Kjo duhet të ketë si rrjedhojë përmirësimin e vazhdueshëm të rezultateve në **zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik, social dhe shoqëror**.

Si parim, duhet të jetë i implementuar në dy mënyra:

- Integrim i nevojave të përbashkëta lokale, i arritur përmes pjesëmarrjes aktive të të gjithë aktorëve lokalë dhe rajonalë, dhe
 - Integrimi i planeve për zhvillimin e sektorëve të cilët duhet të përkrahen mes vetes, me qëllim të sigurimit të kompatibilitetit dhe harmonizimit të aktiviteteve për realizimin e masave të identifikuara.
5. **Cilësia** –duhet të arrihet përmes identifikimit, të bërë mirë, të situatës socio-ekonomike, përparësive krahasuese të definuara mirë, si dhe mundësive të përzgjedhura dhe fushave të intervenimit.
 6. **Inovacioni dhe aftësia e shtuar konkurruese** - Aftësia konkurruese e vlerës së shtuar, e jo e çmimit të ulët të fuqisë punëtore. Si parim ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, gjen zbatimin e vet në përcaktimin dhe definimin e projekteve si dhe në pjesën e formave të mundshme të shfrytëzimit efikas të resurseve në dispozicion, për realizimin e projekteve.
 7. **Ndërlidhje rrjetore ekonomike** Promovim i investimeve dhe ndërlidhje rrjetoreme ekonominë rajonale dhe atë evropiane.

3. Aktivitete themelore të procesit të përgatitjes së Strategjisë dhe Planit të aksionit

Gjatë përpunimit të Strategjisë për ZHLE të Qytetit të Shkupit për periudhën e viteve 2018-2021 u konsultuan njësitë e organizuara të Qytetit që ato ta japin kontributin adekuat në krijimin e Strategjisë. Participimi dhe pjesëmarrja e të gjitha palëve të interesuara në procesin e planifikimit, kontribuojë që kjo Strategji t'i marrë parasysh prioritetet, qëllimet, programet, projektet dhe aktivitetet e palëve të interesuara si dhe përvojat nga realizimi i tyre.

Bazë nisëse gjatë përgatitjes së Strategjisë ishte analizimi i dokumenteve programore, strategjive të komunave/sectorëve, programeve si dhe bisedave dhe komunikimit me njerëzit kompetentë në qytet për atë se si realizohen ata dhe cilat janë pikëpamjet për realizimin e tyre në të ardhshmen. Ai komunikim ishte siguruar përmes pyetësorëve të anketimit, të përgatitur dhe dorëzuar te personat kompetentë dhe përgjegjës nga komunat, sektorët/sectori i biznesit, oda ekonomike dhe ajo e zejtarëve dhe sektori i OJQ, pastaj përmes bisedave me kompetentët nga Qyteti, me antarët e grupit të punës, të formuar nga Qyteti, për përgatitjen e Strategjisë për ZHLE për vitet 2018-2021, me qëllim të analizimit të mënyrës, sipas së cilës, janë realizuar qëllimet e shtruar të deritashme, programet dhe aktivitetet nga strategjitë e veçanta për kompletimin e analizës së gjendjes ekzistuese. Pastaj ishin organizuar punëtori, në të cilat u caktuan prioritetet dhe qëllimet, programet, projektet dhe aktivitetet e definuara në Strategji.

4.Pasqyrë e aktiviteteve më të rëndësishme të realizuara

Për ndërtimin e Strategjisë për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit, me plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021, në periudhën prej shkurtit deri në korrik të vitit 2018, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

1. Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe realizuesit të projektit, EVROSIMOVSKI Konsalting, dhe fillimi i përgatitjes së Strategjisë .
2. Definimi dhe harmonizimi i metodologjisë dhe konceptit me propozim të aktiviteteve dhe kornizës kohore për realizimin e projektit.
Metodologjia i definonte fazat dhe procedurat në procesin e përpunimit të Strategjisë për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit, me Plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021. U definuan kornizat kohore për realizimin e masave konkrete dhe aktiviteteve përmes të cilave sigurohet realizimi i prioritetëve strategjike.
3. Realizimi i prezantimit hyrës dhe punëtorisë për analizën SWOT në Qytetin e Shkupit.
4. Analiza e dokumenteve ekzistuese strategjike dhe e ligjeve relevante për zhvillimin lokal ekonomik.
Revizion i Strategjisë ekzistuese me analizë të shkallës së realizimit të Strategjisë, pasqyrë e mjeteve të planifikuara dhe të realizuara dhe dhënia e komenteve dhe konkluzioneve.

5. Përgatitja dhe dorëzimi i Pyetësorit për analizën e mendimeve për përgatitjen e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit, me Plan të aksionit, për periudhën e viteve 2018-2021.

Përgjigjet dhëna në pyetësin anketues dhe propozimet e shprehura përmes plotësimit të pyetësorit janë pjesë përbërëse e projekteve të propozuara në Strategjinë për periudhën e ardhshme katërvjeçare të viteve 2018-2021.

Ishin të përfshira pyetje lidhur me:

- Gjendjen ekzistuese në Qytetin e Shkupit (me cilat sfida dhe probleme ballafaqohen njësitë e vetëqeverisjes lokale, nevojat e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të NVM)
- Propozimet për përmirësimin e ambientit afarist për zhvillim të gjithëmbarshtëm ekonomik të qytetit dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe qasje të mundshme në burimet e financimit, për nevojat e përparimit dhe zhvillimit
- Idetë dhe propozimet për nxitjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit
- Idetë dhe propozimet për nxitjen e zhvillimit lokal ekonomik (integrim i qëllimeve ekonomike dhe sociale, zgjidhje e sfidave sociale dhe ekologjike për forcimin e rritjes inkluzive)
- Projektet e planifikuara, të cilat kanë rëndësi për zhvillimin lokal ekonomik
- Nevojat e zhvillimit (nevojat e njësive të vetëqeverisjes lokale për zhvillim dhe përparim të mëtejshëm në punën e tyre)
- Potencialet e zhvillimit (potenciale dhe mudësi të cilat ekzistojnë dhe të cilat duhet të theksohen dhe realizohen)

Pyetësi iu dërgua:

- Anëtarëve të grupit të punës nga Qyteti i Shkupit
- Sektorëve në qytetin e Shkupit
- Të gjitha komunave të Qytetit të Shkupit (10)
- Lidhjes së Odave ekonomike dhe Odës ekonomike, e nëpërmjet tyre, odave-anëtare dhe përfaqësuesve të sektorit të biznesit, në përputhje me përzgjedhjen adekuate të odave
- Odës së zejtarëve
- Ministrisë së ekonomisë
- Ministrive dhe institucioneve
- Sektorit joqeveritar (minumum 10 OJQ)

Procedura e dërgimit të pyetësorit u përsërit në muajin qershor me qëllim që të merret një numër optimal i pyetësorëve tërësisht të plotësuar.

6. Analiza e gjendjes ekzistuese në pjesën e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit.
7. Mbajtja e punëtorisë dyditore, më 28- 29 maj, në Veles për përpunimin e Strategjisë për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit.
U organizua seminar (i moderuar) për definimin e vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike si dhe për definimin dhe përpunimin e projekteve, në përputhje me prioritetet strategjike.
8. Analiza e përgjigjeve, mendimeve, propozimeve dhe ideve të marra nga të gjitha palët e përfshira.
9. Projekt-strategjia – drafti
10. Pritja e vërejtjeve
11. Futja e vërejtjeve dhe versionit përfundimtar

5. Gjendja ekzistuese e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit

Për tu fituar një pasqyrë reale për gjendjen ekzistuese në pjesën e zhvillimit lokal ekonomik në Qytetin e Shkupit, u analizuan të dhënat nga dokumentet relevante dhe strategjitë që kanë të bëjnë me Republikën e Maqedonisë, të plotësuara me të dhëna të caktuara statistikore për ambientin afarist dhe gjendjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, standardin jetësor të qytetarëve, cilësitë dhe funksionet hapësinore të qytetit dhe segmenteve të ngjashme si dhe njohuritë e fituara nga hulumtimet e bëra, posaçërisht për nevojat e përgatitjes së kësaj Strategjie, ndërsa kanë të bëjnë me gjendjen e gjithmbarshme për zhvillim të mundshëm dhe potencial në Qytetin e Shkupit. Pasqyra e gjendjes ekzistuese bazohet në paraqitjen tabelare për shkallën e realizimit të Strategjisë paraprake, për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit, për periudhën e viteve 2014-2017, pastaj me anë të analizës së mendimeve dhe të dhënave të fituara gjatë komunikimit me palët e interesuara, si përfaqësues anëtarë të grupit të punës për përgatitjen e kësaj Strategjie; rezultatet nga punëtoritë e mbajtura me përfaqësues nga të gjitha komunat në Qytetin e Shkupit, nga sektori publik e privat dhe odat ekonomike.

Si bazë nisëse gjatë analizës së gjendjes ekzistuese, është revizioni i Strategjisë ekzistuese, me qëllim që të caktohet shkalla e realizimit të Strategjisë së deritashme 2014-2017 dhe të nxirret nevoja reale e bashkësisë lokale.

Pasqyra e shkallës së realizimit të Strategjisë së ZHLE për vitet 2014-2017	
Në vazhdimësi	27% e projekteve dhe e masave, të cilat ishin pjesë përbërëse e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik 2014-2017, kanë rrjedhë të vazhdueshme realizimi të aktiviteteve
Të realizuara	Pjesa më e madhe (51%) e projekteve dhe masave që ishin pjesë përbërëse e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik 2014-2017, janë realizuar tërësisht, me tendencë rritjeje të shkallës së projekteve të realizuara për shkak të vazhdimësisë së aktiviteteve
Të pa realizuara	22% e projekteve dhe masave të cilat ishin pjesë përbërëse e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik 2014-2017 janë të pa realizuara

5.1 Njësi të vetëqeverisjes lokale

Për dallim nga të gjitha njësitë tjera të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, Qyteti i Shkupit shtrihet në rajonet ku shtrihen komunat e Qytetit të Shkupit. Territorin e Qytetit të Shkupit e përbëjnë territoret e komunave:

- Aerodrom
- Butel
- Gazi Baba
- Gjorçe Petrov
- Karposh
- Kisella Voda
- Saraj
- Qendër
- Çair, dhe
- Shuto Orizari

në kufijtë e përcaktuar me Ligjin për Qytetin e Shkupit (G. Zyrtare e RM nr. 55/04).

Rapoti ndërmjet Qytetit dhe komunave të Qytetit të Shkupit është definuar me Ligjin e Qytetit të Shkupit. Ligji i definon saktësisht territoret dhe kufijtë të gjitha komunave të Qytetit. Në qytetin e Shkupit kompetencat, në sferat e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, i kryejnë organet e Qytetit të Shkupit dhe organet e komunave në Qytetin e Shkupit.

Me këtë rast, punët me rëndësi lokale që, në aspektin funksional, janë të pandashme dhe me rëndësi të njëjtë për tërë territorin e Qytetit të Shkupit, i kryejnë organet e qytetit të Shkupit.

Punët me rëndësi lokale që, në aspektin funksional, janë të ndashme për nga karakteri i vet dhe kanë rëndësi për komunat në Qytetin e Shkupit, i kryejnë organet e komunave në Qytetin e Shkupit.

Në kryerjen e punëve, nga kompetenca e vet, qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit realizojnë bashkëpunim të ndërsjellë përmes:

- Këmbimit të materialeve, nga kompetenca e vet, për shkak të informimit të ndërsjellë ose dhënies së pëlqimit;
- Iniciativës së akteve dhe masave për rregullimin e çështjeve në interes të përbashkët për Qytetin e Shkupit;
- Ndërmarrjes së aksioneve dhe masave të përbashkëta për zgjidhjen dhe kryerjen e çështjeve nga kompetenca e vet, dhe
- Dhënies së ndihmës profesionale në zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera.

5.2 Demografi biznesi dhe dinamikë biznesi

Konkurrenca e shëndoshë dhe numri i madh i bizneseve të zhvilluara, zejeve dhe turizmit, janë pjesë e bazës për ekonomi të suksesshme dhe ambient të volitshëm të një vendi. Me reformat ekonomike dhe disa nga politikat, siç janë fushatat për tërheqjen e investimeve të huaja dhe subvencionimi i vetëpunësimit, krijohen kushte për zhvillimin e bizneseve, tanimë ekzistuese, si dhe mbështetjen e ideve për biznese të reja, duke krijuar mundësi për njerëzit e të gjitha shtresave, moshave dhe vendbanimit. Duke i zvogëluar dallimet sociale dhe fenomenet negative sociale dhe duke krijuar kushte të volitshme për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore kanë për qëllim të mundësojnë zhvillim të pa penguar të biznesit dhe zhvillim demografik në tërë vendin.

Për sigurimin e rritjes ekonomike, zhvillimit dhe mirëqenies rëndësi fundamentale ka sigurimi i shpërndarjes së diturisë. Së këndejmi, vendosja e masave për përparimin e inovacionit, paraqet parakusht themelor për realizimin e përfitimeve pozitive ekonomike dhe sociale. Është e pranueshme gjerësisht se inovacionet kanë rëndësi thelbësore për sigurimin e rritjes së prodhimit dhe produktivitetit, në kuadër të ndërmarrjeve, e me vetë këtë, edhe të zhvillimit lokal në tërësi.

Inovacioni është njëra prej praktikave më të njohura dhe themelore për mbështetjen e rritjes ekonomike. Ai paraqet potencial të madh për zhvillimin dhe zgjidhje për një numër të madh sfidash ekonomike e sociale.

Pikërisht për këtë, Qyteti i Shkupit, në drejtim të shndërrimit në qytet të mençur bashkëkohor, duhet nxitur, mbështetur dhe implementuar aktivitetet inovative, duke vendosur zhvillim mbi baza të ekonomisë që bazohet në dituri.

Përmes rekomandimeve nga BE, veçanërisht përmes Strategjisë Evropa 2020, caktohet vizioni për ekonomi evropiane sociale të tregut, për shekullin XXI. Strategjia “Evropa 2020” propozon tre prioritete që plotësojnë njëra tjetrën:

- Rritje e mençur (përkatesisht zhvillim i ekonomisë që bazohet në dituri dhe inovacione),

- Rritje e qëndrueshme (përkatësisht promovim i ekonomisë që i shfrytëzon resurset në mënyrë më efikase, që është më e gjelber dhe më konkurruese) dhe
- Rritje inkluzive (përkatësisht kultivim i ekonomisë me shkallë të lartë punësimi që siguron kohezion social dhe territorial).

Duke u ndërlidhur me “Evropa 2020”, vendet e Ballkanit Perëndimor, që janë kyçur në proceset paraaderuese, përgatitën, gjithashtu, Strategjinë për Evropën Juglindore 2020 (EJL 2020), që paraqet reflektim të vendosmërisë së të gjitha qeverive në Evropën Juglindore për të pranuar qasjet e guximshme në politikat që janë të domosdoshme për arritjen e rritjes së nevojshme ekonomike dhe sociale për përmirësimin e prosperitetit të të gjithë qytetarëve të vet dhe për lehtësimin e integritimit eventual në BE. Në dy dekadat e fundit shënohen përparim i madh dhe arritje shumë të rëndësishme në Evropën Juglindore. Megjithatë, rajoni ende ballafaqohet me sfida të caktuara serioze. Strategjia “EJL 2020” e njeh nevojën e bashkëpunimit rajonal në fushat e zgjedhura, për tu ballafaquar me këto sfida dhe për ta shpejtuar arritjen e qëllimeve zhvillimore në sektorët kyç.

5.3 Analiza SWOT

Përparësitë krahasuese të Qytetit të Shkupit janë identifikuar nëpërmjet analizës SWOT, të bërë në bazë të hulumtimit të anëve të dobëta dhe të forta të ambientit, që i përmban përmbledhja e dokumenteve të tjera strategjike të Qytetit, përpunimit të të njëjtëve si dhe analizës së gjendjes ekzistuese të bërë në punëtoritë e mbajtura.

Përparësitë konkurruese të Qytetit të Shkupit janë treguar si anë të forta dhe i potencojnë faktorët të cilët e bëjnë Qytetin e Shkupit vend të volitshëm pune dhe jetese. Anët e dobëta, të prezantuara si fakte dhe trende, paraqesin pengesa dhe/ose kufizime të zhvillimit. Mundësitë janë kushte të cilat do ta mundësonin dhe lehtësonin zhvillimin e përparësive konkurruese, ndërsa kanosjet janë trende të pavolitshme që ndikojnë në rënien e përparësisë konkurruese të zhvillimit lokal, në raport me qytetet e tjera evropiane.

Për identifikimin e përparësisë konkurruese të Qytetit të Shkupit, janë bërë analiza mendimesh të përfaqësuesve nga Qyteti i Shkupit, gjatë mbajtjes së punëtorisë për pasqyrën e analizës SWOT.

Qyteti i Shkupit, si kryeqendër administrative, afariste, kulturore dhe arsimore, ka shumë anë të forta, por edhe një varg mangësish. Në bazë të kësaj, para qytetit qëndrojnë një varg mundësishë, por ekzistojnë edhe kanosje.

1. Anë të forta	2. Anë të dobëta
1 Vendndodhja e favorshme gjeografike e qytetit 1.2 Potencial i madh ekonomik dhe treg i madh 1.3 Rrjet i zhvilluar tregtar dhe shitje me shumicë 1.4 Komuna të certifikuar miqësore të biznesit (K.Gazi Baba, Qyteti i Shkupit, ...) 1.5 Ekzistimi i një numri të madh të organizatave joqeveritare. 1.6 Kushtet e favorshme për zhvillimin e turizmit dhe për turizëm alternativ. 1.7 Një numëri madh atraksionesh turistike 1.8 Sfera të rregulluara detajisht, në aspektin ligjor 1.9 Kompetenca e decentralizuar e komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit. 1.10 Sistemi bankar i shëndetshëm, me potencial të mirë financimi. 1.11 Një numër ndërmarrjesh të zhvilluara mirë dhe konkurruese 1.12 Klimë e mirë afariste për të bërë aktivitete biznesi. 1.13 Sektori i zhvilluar civil. 1.14 Qendërarsimimi i vendit, me shumë shkolla, universitete dhe institucione shkencore. 1.15 Ekzistimi i infrastrukturës së mirë (rrugore, hekurudhore, aeroportit, komunale, energjetike, telekomunikative, rrjeti i internetit). 1.16 hapësira parkimi të rregulluara. 1.17 Ekzistimi i qendrave kongresiste, turistike dhe ekspozuese. (?) 1.18 Ekzistimi i programeve të vetëpunësimit dhe programeve të tjera për të mbështetur sipërmarrësinë. 1.19 Ekzistimi i ndihmës sociale për të papunët dhe mbrojtje sociale për personat me aftësi të kufizuara. (?) 1.20 Shpenzime më të vogla administrative. 1.21 Trashëgimia e pasur kulturore (objekte	2.1 Shkallë e lartë e papunësisë; 2.2 Indeksi i Lartë i varfërisë, 2.3 Bazëjo e plotë të dhënashstatistikore dhe treguesve në nivelin e Qytetit të Shkupit 2.4 Funksionimi joefektiv dhe joefikas i sistemit të shëndetit publik 2.5 Investime të pamjaftueshme në hulumtime dhe zhvillim; 2.6 Derdhja jashtë e personelit të ri dhe të arsimuar 2.7 Jo stimulim i fuqisë punëtore me kualifikim të mirë 2.8 Mosharmonizim midis ofertës së kuadrit dhe kërkesës së fuqisë punëtore (mungesa e koordinimit të institucioneve arsimore dhe kërkesave të punëdhënësve dhe nevojave të tregut të punës). 2.9 Resurse të pamjaftueshme për investime kapitale në arsim; 2.10 Politizim në përzgjedhjen e kuadrit. (?) 2.11 Mbrojtja e pamjaftueshme mjedisore (rrezik dhe dëmtim i shëndetit të qytetarëve) 2.12 Trajtimi i papërshtatshëm i mbeturinave (selektimi dhe riciklimi) 2.13 Mungesa e njohurive dhe ndërgjegjësimit për problemet e ambientit jetësor dhe rreziqet nga ndotja 2.14 Mungesa e informacionieve dhe njohurive për përfitimet nga futja e sistemeve të menaxhimit të ambientit jetësor; 2.15 Integrimi i pamjaftueshëm i aktiviteteve nga sfera e ambientit jetësor në mjedisin e përditshëm të biznesit 2.16 Niveli i ulët i zbatimit të konceptit të prodhimit më të pastër, parandalimi i ndotjes 2.17 Teknologjitë vjetruara (prodhimi, transporti, ...) 2.18 Nivelet e larta të emetimit të gazrave të dëmshëm (industria, trafiku, amvisëritë, ...) 2.19 Ritmi i ngadaltë për zbatimin e

historike fetare dhe kulturore).	reformave strukturore 2.20 Niveli i ulët i koordinimit në nivel kombëtar, lokal dhe rajonal për zbatimin e politikës së zhvillimit ekonomik. 2.21 Informimjo i plotë dhe asimetric në qytet për mundësitë e funksionimit më të mirë 2.22 Ekonomia me zhvillimtë dobët për funksionimin e mirë të biznesit. 2.23 Niveli i pamjaftueshëm i investimeve vendase dhe të huaja 2.24 Mungesa e aftësive menaxhuese, inovacionit, sipërmarrësisë dhe teknikave të marketingut për të promovuar produktet vendase, veçanërisht në NVM. 2.25 Niveli i ulët i zhvillimit teknologjik në mesin e shumë kompanive (risitë, resurset për burimet alternative të energjisë, etj). 2.26 Burime të pavolitshme financimi dhe çmime të larta të kapitalit; 2.27 Mbështetje e pamjaftueshme për firmat start-ap, 2.28 Niveli i ulët i përdorimit efikas të fondeve të BE-së; 2.29 Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore. 2.30 Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i vlerave kulturore të Qytetit të Shkupit. 2.31 Investime të pamjaftueshme në turizëm; 2.32 Infrastruktura e pamjaftueshme e përgjithshme dhe turistike dhe qasje e pamjaftueshme në destinacionet turistike 2.33 Mungesa e planeve urbanistike të detajuara për të gjitha pjesët e qytetit të Shkupit (!) 2.34 Bashkëpunimi i pamjaftueshëm i komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit me sektorin e biznesit 2.35 Përvoja e pamjaftueshme e administratës publike për përgatitjen e dokumentacionit të projektit dhe përfshirjen e sektorit të biznesit në programet e bashkësisë ndërkombëtare. 2.35 Përvoja e pamjaftueshme e lobimit për
----------------------------------	--

	fonde nga programet dhe projektet e reja; 2.36 Mungesa e institucioneve për kontrollin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve; 2.37 Jolikuiditeti dhe stabiliteti i pamjaftueshëm financiar i kompanive (NVM)
--	---

3. Mundësitë	4. Kanosjet
3.1 Promovimi dhe inkurajimi i mjedisit miqësor të biznesit 3.2 Përdorimi i mundësive të ofruara nga institucionet e BE-së për NVM-të dhe sipërmarrjen 3.3 Përfshirja proaktive dhe aplikimi në projektet e programeve të BE-së për nevojat e qytetit. 3.4 Promovimi më i madh nga Agjencia për Investime të Huaja dhe promovuesit ekonomikë jashtë vendit për investime në Qytetin e Shkupit. 3.5 Mbështetja e proceseve të futjes së inovacioneve (teknologjitë e reja dhe zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja); 3.6 Bashkëpunim më i mirë i qytetit të Shkupit me komunat e Shkupit për marrjen më të thjeshtësuar të vendimeve të nevojshme 3.7 Përmirësimi i qeverisjes lokale-qendrore. 3.8 Zbatimi i standardeve ndërkombëtare dhe të BE-së; 3.9 Nxitja dhe inkurajimi i vetëpunësimit. 3.10 Intensifikimi i bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare 3.11 Rritja e efikasitetit të punës së ndërmarrjeve publike	4.1 Plakja e popullatës në Qytetin e Shkupit 4.2 Konkurrenca nga korporatat e huaja dhe përfaqësitë e tyre për investim 4.3 Atraktiviteti i vendeve të BE-së për punësimin e të rinjve të arsimuar; 4.4. Konkurrencë e jashtme e madhe që mund të çojë në shkatërrimin e kompanive lokale; 4.5 Ikja e fuqisë punëtore të kualifikuar, kryesisht të të rinjve (brain-drain); 4.6 Varësia e lartë nga importet e energjisë 4.7 Globalizimi dhe konkurrenca e madhe në tregun global; 4.8 Përdorimi joracional i ujit të pijshëm. 4.9 Përkeqësimi i gjendjes ekonomike në qytet dhe në shtet.. 4.10 Shpenzime më të mëdha për jetë dhe për zhvillim të biznesit; 4.11 Burime të volitshme financimi të NVM jo mjaft të afërueshme 4.12 Efikasiteti i pamjaftueshëm i sistemit ligjor. 4.13 Rishfaqja e krizës ekonomike në vend dhe në përmasa ndërkombëtare (gjeopolitika) 4.14 Jostabiliteti i mundshëm në rajon dhe në Evropë, i shkaktuar nga kriza e refugjatëve ose terrorizmi. 4.15 Mungesa e fondeve për

3.12 Ndërtimi / përmirësimi i infrastrukturës komunale dhe të trafikut 3.13 Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkomunal 3.14 Përmirësimi i bashkëpunimit të institucioneve vendore me sektorin e biznesit 3.15 Rritja e mbështetjes dhe projekteve për zhvillimin e NVM-ve dhe sipërmarrësisë në nivel lokal 3.16 Gazifikimi i qytetit. 3.17 Zhvillimi i burimeve alternative të energjisë 3.18 Bashkëpunimi midis sektorëve joqeveritarë, shkencorë dhe të biznesit 3.19 Përmirësim i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore 3.20 Rritja e numrit të kompanive të ndryshme për të zhvilluar aftësitë, mësimin dhe zhvillimin përmes punës praktike. 3.21 Parandalimi i ndotjes, eko-efikasiteti, eko-inovacioni dhe transferimi i të ashtuquajturave. teknologji të gjelbra 3.24 Intensifikimi i procesit të bashkëpunimit tejkuftar me komunat/ qytetet e BE-së. 3.25 Rrjetëzimi midis faktorëve të shumtë shoqëror në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. 3.26 harmonizim i plotë horizontal dhe vertikal i rrjetit të institucioneve mbështetëse të NVM-ve. 3.27 Intenzivimi i bashkëpunimit të vetëqeverisjes lokale me sektorin e biznesit dhe institucionet mbështetëse të biznesit 3.28 Përfshirja aktive në rrjetet rajonale të institucioneve mbështetëse të NVM-ve me qëllim të rrjetëzimit rajonal dhe bashkëpunimit ndërmjet firmave 3.29 Subvencionimi i trajnimeve për të papunët dhe i tejkalifikimit të mëtejshëm të popullsisë aktive. 3.30 Angazhimi i personave të papunë dhe të aftë për punë në aktivitete me interes	bashkëfinancimin e projekteve; 4.16 Arsimit i shtrenjtë formal; 4.17 Struktura moshore e pafavorshme e një pjese të të papunëve; 4.18 Proces i ngadalësuar i integritetit të Republikës së Maqedonisë në BE. 4.19 Rritja e pakontrolluar e çmimit të energjisë 4.20 Transferimi i 'teknologjisë së pistë'. 4.21 Popullsia e vjetëruar dhe ulja e pritur e numrit të popullsisë shkollore 4.22 Një sistem i arsimit të lartë që nuk plotëson nevojat e biznesit; 4.23 Vështirësitë organizative, politike dhe financiare në procesin e bashkëpunimit ndërkomunal (rajonal) 4.24 Mungesa e kapitalit të nevojshëm për zhvillimin e industrisë, si nga investitorët vendas ashtu dhe të huaj; 4.25 Kapacitete të ulëta institucionale për absorbimin e plotë të fondeve të ndihmës së paraaderimit;
---	---

publik. 3.31 Inkurajimi i shoqatave klastere 3.32 Promovimi i kulturës së sipërmarrësisë 3.33 Inicimi dhe intensifikimi i veprimtarisë hulumtuese shkencore në institucionet arsimore dhe futja e standardeve të BE-së në një numër të madh sektorësh 3.34 Shfrytëzimi më i madh i kredive nga BNNZH për ndërmarrjet nga qyteti i Shkupit 3.35 Vendosja e masave stimuluese për subjektet ekonomike për aplikimin e teknologjive të pastra, për përdorimin e burimeve alternative të energjisë dhe përdorimin efikas të energjensave. 3.36 Forcimi dhe zbatimi i konceptit të partneritetit publik-privat 3.37 Zhvillimi i programeve për promovimin e vlerave kulturore dhe tradicionale (promovimi i turizmit)	
--	--

6. Vizioni, misioni dhe qëllimet strategjike

6.1 Vizioni

Qytet i prosperitetshëm dhe i hapur, i njëjtë për të gjithë, me infrastrukturë dhe ndërtesa të adaptuara për nevojat e qytetarëve, me shërbime cilësore për qytetarët që do ta vendosin Shkupin në radhën e metropoleve evropiane dhe qyteteve të mençura.

Vizioni është ide e qartë dhe saktësisht e përcaktuar për ndryshimet e dëshiruara për një territor të caktuar urban. Ajo ka një formulim të përgjithshëm dhe nuk ka konkretizim specifik për një sektor të veçantë, por i referohet përparimit të përgjithshëm i cili duhet të arrihet në Qytetin e Shkupit.

6.2 Misioni i Strategjisë

Kjo Strategji ka për qëllim të krijojë parakushte që Qyteti i Shkupit të bëhet inicuese dhe promotore e rritjes së gjithëmbarshme ekonomike.

6.3 Qëllimet strategjike:

1. Qytet i mençur- modernizim i qytetit
2. Nxitje e zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë
3. Ambient i volitshëm afarist
4. Përmirësimi i cilësive dhe funksioneve hapësinore të qytetit
5. Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe standardit jetësor të qytetarëve
6. Energjetika dhe efikasiteti energjetik
7. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës

“Qytet i prosperitetshëm dhe i hapur, i njëjtë për të gjithë, me infrastrukturë dhe ndërtesa të adaptuara për nevojat e qytetarëve, me shërbime cilësore për qytetarët që do ta vendosin Shkupin në radhën e metropoleve evropiane dhe avteteve të mencura”

SHTYLLA 1

Qytet i mençur – modernizim i qytetit

SHTYLLA 2

Nxitja e NVM dhe sipërmarrësisë

SHTYLLA 3

Ambient i volitshëm afarist

SHTYLLA 4

Përmirësimi i cilësive hapësinore dhe funksioneve të qytetit

SHTYLLA 5

Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe i standardit jetësor

SHTYLLA 6

Energjetika dhe efikasiteti energjetik

SHTYLLA 7

Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës

7. Qëllimet strategjike

Qëllimet strategjike, që janë pjesë përbërëse e kësaj Strategjie, janë të orientuara kah disa aspekte, në të cilat theksi u është vënë zhvillimit të konceptit të qytetit të mençur (Smartcity), krijimit të ambientit të volitshëm afarist dhe sektorit konkurrues të NVM, përmirësimit të mjedisit jetësor, zhvillimit të rrjetit të transportit, një pjesë për infrastrukturën rrugore, strukturën komunale, ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë, që do të kontribuojë për një rritje më të mirë ekonomike dhe zhvillimin e qytetit.

7.1 Qytet i mençur- modernizim i qytetit

Koncepti i qyteteve të mençura ka të bëjë me shfrytëzimin e teknologjive të përparuara digjitale për optimizimin e resurseve të qytetit, zvogëlimin e

shpenzimeve, përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe sigurimin e shërbimeve më të mira ndaj qytetarëve.

Në kohën kur qytetet përballen me sfida të mëdha ekonomike dhe ekologjike, pikërisht teknologjia mund të jetë faktor kyç për tejkalimin e problemeve të qytetit dhe përparimin e jetesës urbane.

Për ta lëvizur edhe qytetin e Shkupit në atë drejtim, është parashikuar digjitalizimi dhe qasja elektronike drejt shërbimeve që i jep administrata. Ajo përfshin edhe implementimin dhe mbajtjen e sistemit të mençur për menaxhimin e ndriçimit rrugor, si fillim i projektit “Shkupi smart siti”. Janë parapaë edhe investime për mbrojtjen e ambientit jetësor, përmes shumë projekteve, siç janë: ndërtimi i rrugëve të reja për biçikleta, për këmbësorë dhe trim-rrugë, ngritja e gjelbërimit publik në rrugët magjistrale dhe parqe, projekte për sipërfaqet gjelbra kulmesh në ndërtesa strehimore, e gjithë kjo me qëllim që përqindja e gjelbërimeve në Shkup të rritet në mënyrë drastike.

7.1.1 Transporti publik i mençur

Transporti publik i mençur është zgjidhje modulare e cila përfshin sistemin e gjetjes automatike të automjeteve të transporti publik dhe sistemin e pagesës elektronike të buletave, përmes të cilave sigurohen informata nga të gjitha automjetet dhe pajisjet e lidhura dhe mundësohet kontrolli dhe optimalizimi i aktiviteteve të lidhura me transportin publik, në kohë reale.

Me gjetjen automatike të vendndodhjes së automjeteve nga transporti publik sigurohet optimizmi dhe rritja e efikasitetit të rrjetit të linjave të transportit, përmirësimi i informacioneve që u sigurohen udhëtarëve, e me këtë rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve: rregullshmëri, siguri dhe saktësi e autobusëve. Gjithashtu, kursimi i lëndës djegëse, si rezultat i racionalizimit të transportit dhe qëndrimit më të shkurtër të automjeteve nëpër ndalesat, ndikon dukshëm për zvogëlimin e ndotjes së ajrit. Me pagesën elektronike të buletave që tanimë aplikohet, mundësohet pagesa me kartela elektronike të cilat mund të mbushen përmes internetit, në automate ose në rrjetin e vendeve shërbyese të operatorit të transportit publik si dhe me telefon celular. Në këtë mënyrë mundësohet efikasitet dhe kontroll gjatë punës, ndërsa qytetarëve u mundësohen servise dhe shërbim modern, përshtatur nevojave të tyre. Njëherësh, me zëvendësimin e buletave të letrës kontribuohet në realizimin e përfitimeve më të gjera përkitazi me mbrojtjen e ambientit jetësor.

Pajisja e nevojshme për transportin publik të mençur, për automjetet dhe stacionet përfshin: validatorë, pllaka informacioni, njësi kompjuterike në automjete, pajisje kontrollimi etj., me qëllim që të vendoset dhe sigurohet kontroll i plotëndaj sistemeve

dhe komunikime efikase me operatorët dhe shfrytëzuesit e sistemit të transportit publik, ndërsa si përfitime nga gjithë kjo, paraqiten: përmirësimi i mirëmbajtjes së automjeteve, përmirësimi i menaxhimit me transportin, sigurimi i informacioneve për shfrytëzuesit etj.

7.1.2 Ndriçimi rrugor i mençur

Ndriçimi rrugor kontribuon me më shumë se 40 përqind të llogarive për energji elektrike të qyteteve dhe komunave, dhe mënyra e menaxhimit me të, ka ndikim të dukshëm në shpenzimet e procesit të punës, si dhe në vetë cilësinë e shërbimit. Me implementimin e teknologjive të përparuara dhe inovative, qytetet dhe komunat mundën të menaxhojnë në mënyrë më efikase me ndriçimin e rrugëve, duke u mundësuar, njëherësh, përfitime të rëndësishme qytetarëve.

Ndriçimi rrugor i mençur përfshin:

- Poça elektrike të bazuara në teknologjinë e përparuar LED, me kohëzgjatje të madhe, të cilat mundësojnë shpenzim të zvogëluar të energjisë elektrike dhe mbojtje të ambientit jetësor;
- Senzorë të cilët mundësojnë përshtatje të intensitetit të dritës;
- Pajisje rrjetore e cila mundëson komunikimin ndërmjet poçave dhe sistemit qendror.

Përfitimet e kësaj zgjidhjeje janë: Zvogëlimi i shpenzimit të energjisë, zvogëlimi i shpenzimeve për mirëmbajtje, siguria më e madhe e qytetarëve, ndjekja dhe analiza e performancave të sistemit, përshtatja e ndriçimit varësisht nga nevojat e qytetit dhe, më rëndësishmja, mbrojtja e ambientit përmes zvogëlimit të emetimit të gazrave në sera.

7.1.3 Ndjekja e mençur e cilësisë së ajrit

Zgjidhje e cila siguron matje dhe ndjekje të gjendjes së cilësisë së ajrit, si dhe përçim të informatave për cilësinë e ajrit, institucioneve kompetente me qëllim të marrjes së vendimeve për mbrojtjen e ambientit. Zgjidhja themelore përfshin sensorë të kalibruar me cilësi të lartë, të cilat përdoren për matjen e koncentrimëve të gazit dhe për detektim të koncentrimit të grimcave të dëmshme në ajër, me mundësi për përmirësim me sensorë shtesë për matjen e temperaturës dhe lagështisë relative të ajrit. Të dhënat e grumbulluara nga sensorët përçohen te platforma e softuerit prej nga, të dhënat, sistematizohen dhe analizohen më tutje. Zgjidhja mundet lehtë të

vendoset në cilindo vend të qytetit, edhe atë me shpenzime më të vogla, krahasuar me shpenzimet e stacioneve tradicionale matëse, për ndjekjen e cilësisë së ajrit. Kjo zgjidhje do t'i mundësojë Qytetit të Shkupit që të hyjë më thellë në arsyet themelore të ndotjes së ajrit, si dhe ta ndjek ndikimin e ndryshimeve në politikën publike lidhur me ndotjen e ajrit në një rajon konkret.

7.1.4 Menaxhim i mençur i mbeturinave

Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve për mbledhjen e mbeturinave, me çka u ndihmohet kompanive komunale që t'i përparojnë shërbimet për mbledhjen e mbeturinave, duke i optimizuar shpenzimet operative.

Zgjidhja është fleksibile për lloje dhe madhësi të ndryshme kompanish, për menaxhim me mbeturinat dhe mundëson kursim të shpenzimeve logjistike dhe operative deri në 40%. Siguron informata të hollësishme për statusin e mbushjes së enës për mbeturina që do të mundësojë optimizim dinamik të rrugëve për mbledhjen e mbeturinave dhe zvogëlim të shpenzimeve të panevojshme për transport. Karakteristika e këtillë u mundëson kompanive, të cilat menaxhojnë me mbeturinat, të kujdesen që enët të mos jenë të stërmbohura me mbeturina, e në këtë mënyrë do të ndikojnë pozitivisht në ambientin jetësor, në kënaqësinë e qytetarëve dhe përvojën e turistëve. Zgjidhja mund të plotësohet me sistem identifikimi dhe matjeje të peshës në kamionët, dhe kështu informatat për sasinë e mbeturinave të mbledhura nga kamionët, dhe të dërguara në deponi, të shërbejnë si bazë për zbatimin e sistemit të ri të pagesës, që të mundësohet politikë e drejtë nga organi kompetent për menaxhim me mbeturinat.

Do të arrihej përmes vendosjes së sensorëve në të gjitha llojet e enëve publike për mbeturina, me vendosje modulash për detektim të tejmbushjes së mbeturinave në enë, çipave RFID të cilat vendosen në enët për mbeturina dhe shërbejnë për identifikimin e tyre; si dhe kompjutor qendror i cili vendoset në kabinën e kamionit dhe vagë për matjen e peshës së mbeturinave të mbledhura.

Si përfitime më të rëndësishme të zgjidhjes së këtillë janë: automatizimi i plotë i proceseve për mbledhjen e mbeturinave, mbrojtja e ambientit jetësor, zvogëlimi i shpenzimeve për logjistikë etj.

7.1.5 Zgjidhje e mençur për sigurinë publike

Siguria publike është njëra prej shërbimeve më të rëndësishme që i ofron një qytet, e njëherësh edhe njëra prej zërave më të mëdhenj të shpenzimeve të përgjithshme

për funksionim e qyteteve dhe komunave. Hulumtimet tregojnë se afërsisht 57% e shpenzimeve operative të qytetit i dedikohet sigurisë publike (policia, zjarrfikësit, ndihma e shpejtë). Automatizimi i proceseve në këtë sferë, kontribuon që qyteti t'i optimizojë shpenzimet operative, duke i përmirësuar, njëherësh, shërbimet ndaj qytetarëve dhe cilësinë e jetesës urbane. Zgjidhja e mençur e sigurisë publike, përmes video analizës, në kohë reale, u ndihmon organeve kompetente që t'i monitorojnë sipërfaqet publike, me qëllim të detektimit, në kohë të duhur, të ngjarjeve dhe incidenteve specifike dhe jo të rëndomta. Në këtë mënyrë mundësohet edhe edhe intervenim i shpejtë në terren, që është veçanërisht i rëndësishëm në situata urgjente, kur çdo sekondë është e rëndësishme.

Zgjidhja e mençur e sigurisë publike mundëson që të përmirësohet siguria e përgjithshme në qytet dhe të rritet efikasiteti i zbatimit të ligjit përmes përdorimit të kamerave të rrjetëzuara për mbikëqyrje, në kombinim me një spektër të gjerë modulesh më bashkëkohore për analitikë videosh.

7.1.6 Menaxhimi i mençur i trafikut

Zgjidhja Menaxhim i mençur i trafikut mundëson një pasqyrë të përgjithshme të trafikut në kohë reale, duke i kombinuar vendndodhjet e automjeteve dhe telefonave celularë, me çka u ndihmon administratave të qyteteve në menaxhimin e trafikut nëpër qytet. Zgjidhja analizon sasi të mëdha të dhënash mobile, në kohë reale, që të sigurojnë pasqyrim të plotë në zhvillimin e trafikut. Qyteti mund t'i inkorporojë edhe të dhënat ekzistuese nga detektorët e trafikut, semaforët, sistemet e menaxhimit të tuneleve, kamerat e mbikëqyrjes ose sistemet e informimit për kushtet kohore, për një pasqyrë edhe më të gjithëmbarshme të gjendjes së trafikut. Planifikuesit e trafikut dhe zhvillimit urban, nga të dhënat vijuese dhe ato historike, mund të shohin ku dhe kur ekzistojnë gryka të ngushta në zhvillimin e trafikut dhe të marrin vendime më të mira për planifikimin e zhvillimit normal të trafikut. Planifikuesit e trafikut, në mënyrë plotësuese, mund të bëjnë vlerësim të hollësishëm të ndikimit të mbylljes së rrugëve gjatë ndërtimeve ose riparimeve, kur planifikojnë riorientim dhe anashkalim të zonave në të cilat zhvillohen punimet. Dhe në fund, në saje të infrastrukturës së hapur API, informatat e rëndësishme për zhvillimin e trafikut mund të automatizohen dhe në kohë reale të përçohen në sistemet e jashtme, në formë të raporteve për trafikun. Me mbështetjen e shpërndarjes më efikase të informatave prej qytetit kah qytetarët sigurohet ndihmë për lëvizjen e tyre në trafik, pastaj një analizë më cilësore e trafikut, komunikim i përmirësuar i problemeve në trafik, pasqyrime më të thjeshtësuara të hartave, kohë më e mirë e reagimit, ndarjes së informatave etj.

7.1.7 Parkim i mençur

Zgjidhja parkim i mençur u ndihmon vozitësve të kursejnë kohë për gjetjen e vendparkimit, e zvogëlon ndotjen dhe e zvogëlon rrezikun që qytetarët të bëjnë shkelje gjatë parkimit.

Gjithashtu, mundësohet menaxhim më i mirë me të gjitha sfidat e lidhura mezhvillimin e shërbimit efektiv për parkim publik. Në versionin e vet themelor, zgjidhja thjesht e ndjek statusin e vendparkimeve të lira/të zëna, mund të përdoret për evidencën e hyrjes në parkingjet e mbyllura dhe mund t'i tregojë informatat kyçe në aplikimin me celular ose të shenjave të vendosura strategjike në afërsi të parkingut. Zgjidhja mund të zgjerohet me funksionalitete më të përparura, siç janë dhënia e lejeve për parking (banesore, për vozitës të hendikepuar, taksi, autobusë të qytetit dhe automjete për shpërndarje mallrash), zbatimi i kundërvajtjeve për parkim, pagesa e shërbimit të parkimit, madje mund të kontrollojë qasjen deri te sipërfaqet konkrete për parkim.

Përmes kësaj zgjidhjeje mundësohet një pamje e parkingjeve në tërë qytetin, afrueshmëria e të dhënave për shfrytëzimin e hapësirave të parkimit në kohë reale, zvogëlim i trafikut si dhe zvogëlim i ndotjes.

7.1.8 Mbushja e mençur e automjeteve elektrike

Mbushja e mençur e automjeteve elektrike paraqet ekosistem të hapur TIK i cili i lidh infrastrukturën e mbushjes- mbushës elektrik, softuerin për menaxhim të mbushësve elektrik dhe aplikacionin, e lehtë për përdorim, që u ndihmon vozitësve të automjeteve elektrike që të gjejnë, të rezervojnë dhe të paguajnë për mbushjen e automjeteve elektrike.

Operatorët celularë duhet të sigurojnë platformë bashkëkohore TIK, të bazuar në Cloud, e cila në kohë reale dërgon informata për afrueshmërinë e mbushësve elektrikë deri te shoferi i automjetit elektrik. Infrastruktura e mbushjes mund të vendoset në parking publik, të hapur ose të mbyllur, në qendra tregtare, pompa të benzinës dhesipërfaqe të tjera private ose publike ku është i lejuar parkimi. Në mënyrë plotësuese, infrastruktura e disponueshme lehtësisht për mbushjen e automjeteve elektrike, do ta rrisë përdorimin e automjeteve elektrike në qytet, me çka për një afat të gjatë kohor do të zvogëlohet lëshimi i gazit CO₂ dhe do të përparohet mbrojtja e ambientit jetësor dhe cilësia e të jetuarit urban.

7.1.9 Zgjidhje e mençur për huazimin e biçikletave

Me rritjen e rrëmujave në trafikun nëpër qytete, biçikleta bëhet një prej mjeteve më të dëshiruara të transportit, duke mundësuar zgjidhje më të lirë dhe ekologjike për udhëtimet ditore ose të njehershme nëpër qytet. Huazimi i mençur i biçikletave është koncept i ri dhe interesant, i cili u ofron qytetarëve dhe turistëve mënyrë ekonomike transporti dhe mundësi kursimi të një kohe të konsiderueshme gjatë kalimit të largësive të shkurtëra nëpër qytet. Gjatë aplikimit të teknologjive të mençura dhe inovative, qytetarëve dhe turistëve do t'u ofrohen shërbime bashkëkohore dhe praktike, duke u mundësuar, njëherësh, fleksibilitet të plotë dhe lehtësi gjatë përdorimit.

7.1.10 Menaxhim i mençur i krizave

Gjatë krizave çdo moment është i shtrenjtë dhe informatat kanë rëndësi kyçe. Menaxhimi i mençur me krizat u siguron qyteteve mjet për zvogëlimin e kohës së reagimit në situata krize, për optimalizimin e masave të reagimit dhe mbështetjes së planifikimit të ngjarjeve të mëdha. Përmes kësaj zgjidhjeje, grumbullohen dhe analizohen informatat e depersonalizuara për dendësinë e njerëzve në bazë të të dhënave nga rrjetat mobile, thuaja në kohë reale. Ky rrjedhë e të dhënave, në kohë reale, përpunohet për të treguar përqendrimin e njerëzve në një hartë me rezolucion të lartë. Këto informata janë të dobishme në situata të shumta me të cilat qyteti duhet të menaxhojë, siç janë ngjarjet sportive, tubimet politike dhe koncertet. Nëse ndodh problem, zgjidhja Menaxhim i mençur me kriza, mund të sigurojë informata edhe deri te organet kompetente që të mund të ndërmarrin veprime korrigjimi. Në çdo rast, edhe nëse nuk ndodh ndonjë problem, informacioni ende mund të përdoret për të identifikuar problemet potenciale në zonat e prekura dhe për të siguruar që Qyteti do të mund të përmirësojë, në mënyrë proaktive, përvojën e qytetarëve për ngjarjet e ardhshme.

7.1.11 Tabelë e mençur e kontrollit të qytetit

Tabela e mençur e kontrollit të qytetit u mundëson autoriteteve të qytetit që të kryejnë monitorim nga larg, kontroll dhe optimalizim të infrastrukturës së qytetit. Kjo u jep mundësi që ta përmirësojnë menaxhimin e tërësishëm të infrastrukturës së qytetit, duke siguruar me këtë rast, sukses social, ekologjik dhe ekonomik.

Njëra prej sfidave më të mëdha për t'u bërë Qytet i mençur është gjetja e mënyrës si të tregohet vlera e shërbimeve të reja për qytetarët. Autoritetet e qytetit i përdorin të

dhënat për funksionimin e qytetit, me qëllim që t'i kuptojnë dhe t'i zgjidhin problemet e jetesës urbane të qytetit, si ndihmë gjatë formulimit të politikave publike dhe për orientimin e menaxhimit afatgjatë operativ. Duke pasur parasysh se numri i aplikimeve të mençura dhe teknologjive të përparuara për përparimin e punës së qyteteve rritet për çdo ditë, të kuptuarit dhe shfrytëzimi i këtyre të dhënave bëhet gjithnjë e më kompleks dhe më kritik. Zgjidhja Tabelë e mençur e kontrollit të qytetit është mjet, i cili në bazë të analizës së një sasive të madhe të të dhënave të ndryshme dhe shpejt të ndryshueshme, i identifikon trendet të cilat ndikojnë në aktivitetet e përditshme operative të qytetit, duke përmirësuar, me këtë rast, kontrollin ndaj infrastrukturës së qytetit. Tabela e mençur e kontrollit të qytetit do t'u ndihmojë qyteteve që ta kuptojnë dhe ta tregojnë ndikimin e të dhënave urbane, si dhe t'i shfrytëzojnë ato për përmirësimin e qytetit dhe shërbimeve ndaj qytetarëve dhe turistëve.

7.2 Nxitja e zhvillimit të NVM dhe sipërmarrësisë

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me qëndrueshmërinë, vitalitetin dhe inventivitetin e tyre, janë gjeneruesit e punësimeve të reja dhe mobilizuesve të të gjithë faktorëve të prodhimit. Ata bëhet gjithnjë e më atraktiv në shoqërinë globale, prandaj imponohet nevoja e ndërtimit të infrastrukturës dhe rregullativave për mbështetjen e tyre efektive. Infrastruktura sipërmarrëse ka rol kyç në zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, kurse mungesa e infrastrukturës adekuate ka veprim inhibues, jo vetëm ndaj zhvillimit të tyre, por edhe në përgjithësi, ndaj zhvillimit ekonomik.

Qyteti i Shkupit vendos politika për mbështetjen e rritjes së lartë të NVM. Këto politika përfshijnë dy çështje:

- Politika për nxitjen e numrit të shtuar të NVM, si dhe
- Politika për mbështetjen e NVM, me qëllim që të mbetet rritja e tyre e lartë.

Politikat e nxitjes së numrit të rritur të NVM sigurojnë ambient të volitshëm afarist për rritjen dhe zhvillimin e ardhshëm të lartë të kulturës sipërmarrëse, ndërsa politikat e mbështetjes së rritjes së lartë të NVM, kanë për qëllim të sigurojnë një sektor konkurrues dhe produktiv të NVM.

Mosinformimi dhe informimi asimetrik paraqitet si problem kryesor me të cilin ballafaqohen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, start-apët si dhe të gjithë qytetarët të cilët drujnë për të ardhmëne pasigurt gjatë fillimit të biznesit vetjak. Me qëllim të zvogëlimit të ndikimit të këtij problemi, do të realizohen fushata për promovimin e mbështetjes, programeve dhe trajnimeve të financuara nga Bashkimi Evropian, do të promovohet kultura sipërmarrëse, sipërmarrësia kreative, sipërmarrësia sociale, si

dhe këmbim rrëfimesh të suksesshme sipërmarrësie, me qëllim të inkurajimit të sipërmarrësve potencialë.

Në pajtim me rekomandimet e caktuara përmes pyetësorëve anketues dhe konsultimeve me njësitë e vetëqeverisjes lokale, me sektorin e biznesit dhe atë joqeveritar, Qyteti do t'i forcojë konsultimet e veta dhe mekanizmat për të zhvilluar dialog me sektorin privat. Vemendje e veçantë do t'u kushtohet përfshirjes së femrave afariste në këta mekanizma si dhe ndërmarrjeve mikro.

Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) mundëson të ndjehen efektet e tyre sa më shpejtë në: punësim, rritjen e prodhimit, në forcimin e konkurrencës, zhvillimin social dhe, në përgjithësi, në zhvillimin njerëzor.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme gjithnjë e më shumë ballafaqohen me konkurrencën ndërkombëtare dhe e analizojnë nevojën për t'iu përshtatur ndryshimeve të ambientit të tyre strategjik. Kjo, jo vetëm që nënkupton përshtatje të strategjive të tyre të vendit, por gjithnjë e më tepër firmat vendosin që aktivitetet t'i zgjerojnë jashtë kufijve të vendeve të tyre. Me qëllim që të ballafaqohen me sfidat e këtilla, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhet të jenë të vetëdijshme se konkurrenca e rritur duket se rrënjohet edhe në perspektivat e brendshme edhe në ato të jashtme të punës së tyre.

Pikërisht për këtë, Shkupi, përmes mbështetjes financiare të projekteve për organizimin e trajnimeve dhe shërbimeve këshilluese, përmes promovimit të nevojës së certifikimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare për cilësi (ISO), do t'i nxisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të përsosen në drejtim të aftësisë së tyre konkurruese, që do të ndikojë pozitivisht ndaj hapjes së punësimeve të reja dhe zhvillimit ekonomik.

7.3 Ambienti i volitshëm afarist

Qyteti i Shkupit, si fitues i certifikatës për ambient të volitshëm afarist, e konfirmon qëndrimin për destinacion të dëshiruar afarist me ambient të volitshëm biznesi. Përmes forcimit të infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimin e infrastrukturës së re për mbështetje afariste, përparohet mbështetja dhe nxiten inovacionet afariste edhe të kompanive inovative. Duke pasur parasysh se forca kryesore lëvizëse e ekonomisë në vendin tonë janë ndërmarrjet private, bizneset e vogla si dhe zejtarët, të cilët janë segmenti kryesor për krijimin e vendeve të reja të punës, rritja e eksportit, krijimi i prodhimeve dhe shërbimeve inovative, promovim më i madh i prodhimeve të vendit në tregjet e huaja etj.

Duke pasur parasysh se pikërisht bizneset e vogla dhe zejtarët janë thithësit kryesorë të papunësimin dhe promotorë të inovacionit, është me rëndësi prioritare që

të përcaktohet politika konzistente për mbështetjen e zhvillimit të tyre të papenguar , për shkak të rolit të madh dhe rëndësisë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Proceset e pashmangshme që ndodhin në mjedis karakterizohen nga ndryshime dinamike teknologjike, rritja e konkurrencës globale, pasiguria dhe rreziku. E gjithë kjo inicion nevojën për përkrahjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zejtarëve dhe nënkontraktorëve (freelancers), të tjerë krijues dhe të pavarur të cilët, me inovativitetin, kreativitetin dhe rritjen e përhershme të produktivitetit dhe fleksibilitetit, do t'u përgjigjen kushteve të reja dhe do të kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimi i përgjithshëm shoqëror.

Prandaj, Qyteti i Shkupit, në bashkëpunim me institucionet dhe odat kompetente, siguron mbështetjen e nevojshme me qëllim krijimin e një mjedisi në të cilin sipërmarrësit dhe ndërmarrjet familjare mund të përparojnë dhe në të cilin shpërblehet sipërmarrësia. Do të krijohet një ambient i volitshëm afarist për të gjitha NVM, vend pune të mirë për të gjitha NVM-të, përfshirë ndërmarrjet familjare, përmes një kuadri ligjor dhe rregullator të thjeshtuar, krijim politikash dhe koordinim i përmirësuar dhe nëpërmjet shërbimeve të përmirësuara për zhvillim afarist dhe qasje më të mirë në financa.

Për zhvillimin e duhur ekonomik, nevojitet një bashkëpunim përkatës ndërmjet Qytetit të Shkupit me komunat e tjera, në drejtim të krijimit të zonave industriale kllasterëve, parqeve teknologjike, qendrave inovative, qendrave të rikualifikimit dhe kualifikimit shtesë, për trajnim afarist dhe konsultim, zonave të marketingut për investitorët, atraksioneve turistike etj.

Për zhvillimin ekonomik nevojitet edhe bashkëpunim me qytetet e vëllazëruara, me të cilat qyteti ynë dhe komunat kanë të vendosur marrëdhënie të bashkëpunimit të ndërsjellë për ringjallje të shpejtë dhe të lehtë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zinxhirëve ndërkombëtarë të vlerave në lidhje me tërheqjen e investitorëve të huaj etj.

Si tregues të zhvillimit ekonomik shërbejnë rritja e investimeve në nivel komunal, numri i vendeve të reja të punës (sidomos në aspektin e zejtarisë, turizmit dhe sektorëve të tjerë potencialë), rritja e vlerës së eksportit dhe numri i eksportuesve, rritja e PBV-së dhe rritja e pagës mesatare.

7.4 Përmirësimi i cilësive dhe funksioneve hapësinore të qytetit

Një segment i rëndësishëm i planifikimit të zhvillimit të përgjithshëm dhe lokal të qytetit të Shkupit përfshinë cilësitë hapësinore dhe funksionet e qytetit. Hapësira si sistem ose sistemi hapësinor nënkupton një sërë elementësh, modulesh dhe nënsistemesh të lidhura në një tërësi funksionale, me qëllim krijimin e një mjedisi

funksional, ekonomik, human dhe estetik mjedisi në të cilin njerëzit do të gjejnë kushte të favorshme për punë dhe jetesë .

Kjo nënkupton infrastrukturë funksionale rrugore, teknike dhe komunale dhe shërbime adekuate. Qëllimet e planifikimit hapësinor paraqesin mënyrë të formësimit të qëndrimeve dhe racionalizimit të kuptimit për hapësirën dhe ndryshimin e saj në bazë të interesve të përbashkëta të bashkësisë shoqërore.

Për komunitet dhe qytetin e Shkupit, në plan të parë është infrastruktura dhe shërbimet komunale, kryesisht për shkak se ato janë nën kompetencë të vetëqeverisjes lokale, por në procesin e planifikimit strategjik, në asnjë rast nuk duhet lënë pas dore, sepse ato ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e jetës së qytetarëve. Kjo do të thotë se një nga qëllimet e rëndësishme për zhvillimin lokal është përmirësimi i këtij lloji të infrastrukturës.

Ky qëllim strategjik, përpiket për të krijuar kushte më të mira për jetëme shpenzime minimale për ndërtim, nëpërmjet përdorimit optimal të avantazheve natyrore, dhe në përputhje me mundësitë, kushtet për zhvillimin, teknikën dhe teknologjinë që janë në dispozicion të bashkësisë më të gjerë (krijimi i një mjedisi funksional, ekonomik, human dhe estetik të mirëqenien shoqërore, humanizimi i hapësirës dhe rritje e cilësisë së mjedisit shoqëror), i shprehur përmes fushave të ndryshme - për urbanizëm dhe planifikim hapësinor, për trafik, efikasitet energjetik për çështjet komunale etj.

Për tu harmonizuar zhvillimi i hapësirës së Qytetit të Shkupit me supozimet e zhvillimit në nivel të lartë, mënyrën dhe vëllimin e kërkesave për shfrytëzimin e hapësirës, dedikimin themelor dhe shfrytëzimin e tokës, nevojitet të analizohet zhvillimi shoqëror dhe lëvizja e popullatës dhe të definohen hapësirat e përshtatshme për zhvillim të industrisë, bujqësisë, pylltarisë, turizmit etj.

Nevojat e forcimit të identitetit të qytetit të Shkupit, për zhvillim urban të qëndrueshëm dhe të prosperitetshëm, për përmirësimin e kushteve komunale, sigurimin dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike, mirëmbajtjen dhe modernizimin e infrastrukturës komunale e të ngjashme, kanë një rrjedhë të vazhdueshme aktiviteteve në drejtim të krijimit dhe ndërtimit të një qyteti të mençur i cili do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të tij.

Problemet të cilat paraqiten nga pjesa e infrastrukturës rrugore, teknike dhe komunale, zgjidhen në mënyrë më cilësore dhe më ekonomike përmes bashkëpunimit të ndërsjellë të Qytetit me komunitetin, përmes përgatitjes dhe implementimit të përbashkët të projekteve infrastrukturore, të cilat kanë ndikim në cilësinë e jetës dhe zhvillimin shoqëror, në vendosjen e përbashkët të institucioneve për mbrojtje sociale dhe shëndetësore, si dhe në themelimin e qendrave të përbashkëta të trajnimit, rikualifikimit dhe mbikualifikimit të personave të papunësuar,

zejtarëve e të ngjashme, që krahas aspektit social, ka kontribut të tërthortë edhe në sferën e zhvillimit ekonomik.

7.5 Përmirësimi i cilësisë së jetesës së qytetarëve

Cilësia e jetës ka të bëjë me mirëqenien e njerëzve. Ajo përfshin disa komponente, ndër të cilat, disa janë të matshme, si për shembull - standardi i jetesës dhe disa të tjera nuk janë të matshme, siç janë lumturia, liria për të zgjedhur, shëndeti, ambienti jetësor, koha e lirë, siguria, arsimi, jeta shoqërore etj.

Standardi i jetesës është sasia dhe cilësia e pasurisë (të mirave) dhe shërbimeve që janë në dispozicion të njerëzve, si dhe mënyra në të cilën shpërndahen ato pasuri dhe shërbime midis tyre. Të gjitha ekonomitë dhe qytetet janë duke u përpjekur për një rritje më të madhe ekonomike. Megjithatë, në mënyrë që rritja ekonomike të konsiderohet si cilësore, është e nevojshme të gjenerohen punësime të reja. Ekonomitë moderne përballen shpesh me fenomenin jobless growth (ritjes së papunësisë), sipas të cilit rritja ekonomike nuk është shoqëruar me rritje adekuatë të punësimit (shkalla e rritjes së punësimit nuk e ndjek shkallën e rritjes së të ardhurave). Mungesa e punësimeve të reja ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së njerëzve, dhe në veçanti, shkakton një rritje të shkallës së varfërisë.

Cilësia e rritjes ekonomike varet nga ajo, a është dhe sa është fizikisht destruktive rritja ekonomike, përkatësisht a ndikon dhe sa ndikon në reduktimin e fondit pyjor, ndotjen e ujit, tokës, ajrit etj. Me këtë rast, duhet të merret parasysh se, degradimi i ambientit jetësor, aq sa është i rrezikshëm për të tashmen, po aq, madje edhe më shumë, është i rrezikshëm për gjeneratat e ardhshme.

Ndërkaq, zhvillimi i qëndrueshëm nuk është i lidhur vetëm me ambientin jetësor. Ai është i lidhur edhe me sistemin shoqëror dhe ekonomik, të cilët me fleksibilitetin e vet duhet të kontribuojnë për ruajtjen e mundësive dhe shanseve që gjeneratat e ardhshme të jetojnë me, të paktën, nivel të njëjtë të cilësisë së jetës ashtu si gjeneratat e tashme.

Pikërisht për këtë, kjo Strategji është orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve, duke mbajtur llogari, pik së pari, për mbrojtjen e shëndetit të tyre, përmes mbrojtjes së ambientit jetësor, vendosjes së infrastrukturës adekuatë komunale dhe rrugore.

Qyteti i Shkupit ndërmerr aktivitete përkatëse në drejtim të nxitjes së qytetarëve, bashkësisë së biznesit dhe autoriteteve lokale që të iniciojnë proaktivitet dhe të vendosin bashkëpunim, me qëllim të përmirësimit të kushteve të gjithëmbarshme për jetë.

7.6 Energjetika dhe efikasiteti energjetik

Koncepti i efikasitetit energjetik shndërrohet në prioritet gjithnjë e më të madh për zhvillimin lokal ekonomik, veçanërisht për qytetin e Shkupit. Duke pasur parasysh se kursimet e energjisë kanë rëndësi jetike për mbrojtjen e ambientit jetësor, e njëherësh, janë një prej mënyrave më të fuqishme dhe më efektive për arritjen e ardhmërisë së qëndrueshme energjetike, ky qëllim strategjik shpie në nevojën e zvogëlimit të harxhimit të energjisë, zëvendësimit të shfrytëzimit të resurseve jo të rinovueshme, me resurse të rinovueshme, zëvendësimit të konsumit joefikas të energjisë me konsum efikas, izolimit të hapësirve që shfrytëzojnë ngrohje etj.

Qyteti i mbështet aksionet e kompanive për aplikimin e praktikave të qëndrueshme në punën e përditshme, të orientuara kah mbrojtja e ambientit jetësor, përmes prodhimeve dhe praktikave efikase në aspektin energjetik. Performansa e përparuar shpie drejt efikasitetit të rritur të resurseve dhe kursimeve të drejtpërdrejta, ndërsa mundet edhe ta rrisë edhe qasjen ndaj klientëve të cilët kërkojnë prodhime dhe shërbime ekologjike dhe me efikasitet energjetik.

Qëllimi kryesor është zvogëlimi i shpenzimeve për energji në qytet, para së gjithash, të objekteve të komunave të cilat janë në kompetencë të tyre, si dhe për ndriçimin rrugor, sigurimin e kushteve normale (standarde të rehatshme) për qëndrim dhe punë në të gjitha hapësirat, sigurimin e infrastrukturës së qytetit (ndriçim publik), zvogëlimin e lëshimit të materieve të dëmshme në ajër dhe rrethinë, përdorimin më të madh të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Qëllimi themelor do të realizohet përmes realizimit të modernizimit të ndërtesave që janë në pronësi të qytetit, ndryshimit të shprehive të të gjithë shfrytëzuesve të ndërtesave, trajnimit të personelit përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e masave për efikasitetin e energjisë, ndërgjegjësimin të qytetarëve.

7.7 Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës

Nevojat për bashkëpunim ndërkomunal janë më të shprehura dhe më të dukshme pikërisht në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor për arsye se pikërisht mbrojtja e ambientit jetësor është njëra prej sfidave më të mëdha të së sotmes. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekologjik dhe shfrytëzimi inteligjent i energjisë janë ndër qëllimet themelore të Qytetit të Shkupit. Qyteti i mbështet ekonominë e gjelbër përmes eko- inovacioneve dhe shërbimeve nga sfera e ambientit jetësor me qëllim

të gjenerimit të mundësive të biznesit nga sfidat ekologjike, përmes të cilave mundësohet që kompanitë ta përparojnë performansën ekologjike dhe energjetike, t'i zvogëlojnë shpenzimet dhe të kenë qasje në tregjet e gjelbra. Çdonjëri është i obliguar që t'i mbrojë dhe përparojë ambientin jetësor dhe natyrën.

Nevojitet të bëhet grumbullimi i organizuar, sistematik dhe ekonomik, ndarja dhe riciklimi i materialeve të mbeturinave, përmes vendosjes së deponive rajonale. Është i nevojshëm një promovim i nevojës dhe zhvillimit të vetëdijes për obligimin që të mbrohet, ruhet dhe përparohet ekosistemi natyror. Përveç zgjidhjes së përmirësuar ekonomike dhe efektive të problemeve të qytetit, vendosen edhe mundësi për hapjen e vendeve të reja potenciale të punës, përmes reparteve për riciklimin e mbeturinave.

Deri më tash haseshim me mosndërmarrjen e masave konkrete për zvogëlimin e ndotjes së ajrit. Si pasojë e këtij kujdesi jo të mjaftueshëm, qyteti ynë është ndër qytetet më të ndotura në Evropë. Pikërisht për këtë, Qyteti i Shkupit do të fillojë politikën e detyrimit të kapaciteteve të mëdha industriale për implementimin e standardeve ekologjike, me qëllim të vendosjes së filtrave përkatës. Shërbimet e inspektimit të pushtetit lokal do të fillojnë të kujdesen për zbulimin adekuat dhe cilësor dhe për sanksionimin e ndotësve.

Do të thellohet bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal, në drejtim të ndërmarrjes së masave konkrete sistemore për zvogëlimin e ndotjes së ajrit.

Gjithashtu imponohet nevoja e menaxhimit adekuat me deponitë të cilat më shpesh gjenden në periferi të vendeve të banuara, të cilat nuk janë të shënuara as të rrethuara dhe as që kanë shërbim rojesh. Me qëllim që të zvogëlohet efekti negativ nga mbeturinat e shpërndara gjithandej dhe nga era e padurueshme, do të bëhen veprime përgatitore për realizimin e projektit për deponimin rajonal të mbeturinave, sipas të cilit është paraparë vendosja e qendrave grumbulluese dhe ndërtimi gradual i deponive rajonale, në të cilat, përveç deponimit të mbeturinave sipas rregullave, do të bëhet selektimi dhe riciklimi.

Për këtë qëllim, qyteti i Shkupit do të fillojë informimin e publikut për nevojën e veprimit adekuat dhe menaxhimit me mbeturinat, me qëllim të përfshirjes së një numri sa më të madh të institucioneve kompetente, organeve, organizatave joqeveritare dhe kompanive në realizimin e projekteve për vendosjen e qendrave të grumbullimit dhe deponimin rajonal të mbeturinave.

Gjithashtu, është i domosdoshëm një bashkëpunim ndërkomunal sa i përket mbrojtjes së rrjedhave ujore dhe mbrojtjes nga vërshimet. Këta rreziqe potenciale i tejkalojnë kapacitetet e një komune për tu ballafaquar me ato dhe kërkon një veprim të harmonizuar të të gjitha komunave dhe qytetit, që janë të interesuar për zgjidhjen e problemit.

Në drejtim të marrjes së titullit “Kryeqytet i gjelbër evropian” deri në vitin 2021 dhe për tu realizuar koncepti i qytetit të qëndrueshëm, Qyteti i Shkupit ndërmerr masa

dhe parime përkatëse për pengimin e ndotjes, krijojnë një përbashkësi ndërmjet shoqërisë, ekonomisë dhe ekosistemeve, valorizim të shumëllojshmërisë kulturore, ekonomike dhe ekologjike për sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm për interaksione njerëzore, arsim, punësim, rekreim, strehim, ekonomi dhe zhvillim kulturor, u jep mbështetje politikave dhe programeve qëparashikojnë shfrytëzim efikas të resurseve njerëzore dhe u bën thirrje entiteteve të tjera dhe subjekteve për nxitjen e iniciativave dhe ndërmarrjen e masave të mbrojtjes nga ndotja dhe pengimit të ndotjes.

Mbrojtja e ambientit nënkupton dhe kërkon ekzistimin e kapaciteteve të cilat mund të kryejnë matje periodike, për çka nevojitet pajisje e veçantë dhe kuadër profesional. Indikatorët që duhet të përcillen në kuadër të pjesës për mbrojtjen e ambientit jetësor janë:

- rritja e numrit të institucioneve, organizatave dhe kompanive me vendosje të standardit ISO 14000
- raporti në mes të prerjes së drunjve dhe pyllëzimit
- numri i deponive të egra
- sasia e mbeturinave të përpunuara/ricikluara
- numri i pacientëve që kanë probleme me rrugët e frymëmarrjes
- numri i ditëve vjetore, kur uji dhe ajri kanë qenë të shpallur të ndotura.
- numri i llojeve të rrezikuara bimë dhe shtazore
- numri i kontrolleve të bëra të aspekteve kyçetë ndotjes së ujit, tokës dhe ajrit etj.

Varësisht nga specifikat e ambientit dhe qëllimet e shtrëguara për mbrojtjen e ambientit jetësor, duhet definuar rreziqet kryesore dhe të vendoset sistemi i ndjekjes së lëvizjes së tyre.

Kjo është e mundur në nivel të bashkësisë lokale, e në rastet e mungesës së kapaciteteve për matje specifike, mund të angazhohen resurse nga sektorë të tjerë (kompani dhe organizata që merren me këtë fushë) me qëllim që të vendosen kapacitete adekuate për matje të këtyre për një afat të gjatë.

8. Implementimi, kontrolli, masat e korrigjimit dhe revizioni i Strategjisë

Strategjia për zhvillim lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit ka një kohëzgjatje për periudhë 4 vjeçare (për vitet 2018-2021). Për implementimin e saj do të kujdeset Qyteti i Shkupit, përkatësisht Sektori për zhvillim lokal ekonomik, së bashku me sektorë të tjerë si dhe komunat në Qytet.

Për realizimin e suksesshëm të Strategjisë, pas miratimit të saj dhe hyrjes në fuqi, Qyteti i Shkupit do të fillojë realizimin e një pjese të projekteve të parashikuara me Planin e aksionit si dhe përcaktimin e plotë të mjeteve të nevojshme.

Në përpunimin e Strategjisë rol kyç pati puna e grupit të punës, të përbërë nga të gjithë aktorët në Qytetin e Shkupit, që janë të rëndësishëm për zhvillimin lokal ekonomik.

Në Strategji janë inkorporuar perceptimet e tyre për gjendjen aktuale në qytet, nevojat dhe pritjet e tyre për mbështetje dhe për orientimet e zhvillimit, si dhe gatishmëria e Qytetit të Shkupit t'ua përmbushë kërkesat e tyre. Ndjekja e statusit të realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit, do të realizohet nëpërmjet roleve dhe përgjegjësi të caktuara dhe definuara qartë të bartësve dhe shfrytëzuesve të masave dhe aktiviteteve konkrete dhe obligimit të tyre për t'u dhënë informatë kthyesë në kohe, atyre që janë përgjegjës për realizimin dhe definimin e aktiviteteve dhe projekteve, si dhe nevojave për harmonizime dhe ndryshime eventuale të Strategjisë dhe Planit të aksionit. Bartës i procesit të përgatitjes dhe realizimit të Strategjisë dhe Planit të aksionit për zhvillim lokal ekonomik për periudhën e viteve 2018-2021, është Qyteti i Shkupit, përkatësisht Sektori për zhvillim lokal ekonomik i Qytetit të Shkupit.

Revizioni dhe kontrolli i rregullt, përmes mbajtjes së takimeve, në çdo tre muaj, të grupit të punës nën koordinimin e Qytetit të Shkupit, përkatësisht Sektorit për zhvillim lokal ekonomik, e nën kujdesin e prefektit të Qytetit të Shkupit, janë aktivitete kyçe për ndjekjen e realizimit dhe implementimit të Strategjisë. Për implementimin e suksesshëm të kësaj Strategjie është veçanërisht e rëndësishme të sigurohen resurset e nevojshme, e para së gjithash, mjete financiare, të parashikuara në Planin e aksionit. Për këtë qëllim, është e nevojshme që Qyteti t'i fusë, mjetet e nevojshme për realizimin e projekteve nga Plani i aksionit, në buxhetet e veta vjetore, ndërsa për vitin 2018 të përgatisë ribalanc të buxhetit, me çka do të sigurohen mjetet e nevojshme, dedikuar realizimit të projekteve të parashikuara për vitin 2018. Qyteti i Shkupit, duke pasur parasysh se një numër i madh projektsh në Planin e aksionit kanë më shumë burime financimi (për shkak të pamundësisë së Qytetit për t'i siguruar të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e tërë Strategjisë), është e nevojshme që, në mënyrë proaktive, të planifikuar dhe në bashkëpunim të të gjithë sektorëve në Qytet, e nën koordinimin e Sektorit për zhvillim lokal ekonomik, Sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe Sektorit të financave, të punojë në gjetjen e mjeteve financiare nga burime të tjera (nga organizata vendore dhe ndërkombëtare, agjenci zhvillimore, fonde evropiane e fonde të tjera etj.) për realizimin e kësaj Strategjie. Për çdo projekt të theksuar në këtë Strategji, Qyteti i

Shkupit, pas miratimit të Strategjisë, nevojitet të shpallë thirrje për zbatues për çdo projekt të veçantë, të inkuorporuar në Planin e aksionit.

Realizimi i Strategjisë varet nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që janë me rëndësi kyçe për zhvillimin lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit. Në përputhje me këtë, nevojat, prioritetet, masat dhe aktivitetet në Strategji mund të pësojnë ndryshime. Këta ndryshime do të shqyrtohen dhe lejohen në takimet e rregullta tremujore të grupit të punës.

9. Plan i aksionit

Propozimprojektet e theksuara, të cilat janë pjesë përbërëse e Planit të aksionit të Strategjisë për zhvillim lokal ekonomik të qytetit të Shkupit, për periudhën e viteve 2018-2021, janë vendosur me qëllim që të kenë efekte të shumëfishta në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë.

Qëllimi kryesor është një shtrirje dhe cilësi më e madhe e shërbimeve publike në nivel lokal, që synojnë të sigurojnë kushte stabile për aktivitetin ekonomik, mbështetjen e sektorit të biznesit lokal, tërheqjen e investimeve të reja, mbrojtjen e ambientit jetësor, përmirësimin e infrastrukturës dhe funksioneve hapësinore të qytetit, si dhe standardin e përgjithshëm të jetesës së qytetarëve. Arritja e qëllimeve të këtilla nënkupton implementim konsekuent të konceptit të ZHLE.

Plan i aksionit përmban një pasqyrë orientuese të projekteve prioritare (projekte të vlerësuara dhe me pikët e dhëna gjatë vlerësimit, përkitazi me tre aspekte edhe atë: relevanca/arsyeshmëria e masës/projektit, prioriteti i masës/projektit, realizueshmëria (mundësitë) dhe parakushtet e realizimit të masës/projektit, si dhe përpunim i hollësishëm i projekteve sipas sferave, me qëllim strategjik të përcaktuar dhe definuar, të cilit i përket një projekt konkret, pastaj përshkrimi i shkurtër, qëllimi dhe grupet e synuara, korniza kohore dhe financiare e projekteve të propozuara.

PLANI I AKSIONIT PËR ZHLE (2018 – 2021)

Propozime me rëndësi strategjike për zhvillimin e Qytetit të Shkupit					
Qëllime, masa dhe projekte	Vlerësi m përfund imtar / P R I O R I T E T E	Përshkrim i shkurtër Qëllimet dhe grupet e synuara /shfrytëzues (beneficiary)	Periudha e implementi mit / korniza kohore/ afatet	Rezultate të pritura	Konstrukt. Financiar (shuma), shpenzime për resurse të domos- doshme
1. Ckonje – Smart City („qytet i mençur“)	18	<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Qytet i mençur – modernizimi i qytetit</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Globalizimi, zhvillimi i vrullshëm ekonomik, teknologjik, informatik të komunikimit e imponojnë nevojën që qytetet e mëdha/komunat ta aplikojnë sistemin e smart city/smartcommunity, i cili bazohet në mënyrën e re të funksionimit dhe komunikimit me qytetarët, përmes shfrytëzimit të teknologjive të përparuara informatike të komunikimit për shfrytëzimin maksimal të resurseve të komunës, për shpenzime të zvogëluara, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Në këtë sistem përfshihen sisteme informatike të shërbimeve lokale, smart city/smartcommunity, promovohet për	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Përmirësimi i cilësisë së jetës Sigurim i shërbimeve më të mira për qytetarët Optimizimi i resurseve të qytetit	



		shfrytëzimin e informatikës dhe teknologjisë urbane për përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve. TIK u mundëson autoriteteve komunale që të komunikojnë drejtpërdrejtë me bashkësinë dhe me infrastrukturën komunale për ta ndjekur atë që ndodh në komunë, si zhvillohet komuna dhe si të mundësohet cilësi më e mirë e jetës. Aplikimi i konceptit smart do të mundësojë që prefekti, Këshilli dhe administrata, të komunikojnë drejtpërdrejtë me qytetarët, ndërsa qytetarët do të mundën drejtpërdrejtë të përfshihen në punën e komunës. Në kuadër të projektit për qytet të mençur (Smart City) mund të përparohen këta aspekte të funksionimit të qytetit: - Transport publik i mençur - Ndriçim i mençur rrugor - Menaxhim i mençur me trafikun - Parking i mençur - Menaxhim i mençur me mbeturinat - Ndjekje e mençur e cilësisë së ajrit - Zgjidhje e mençur për sigurinë publike - Huazim i mençur i biçikletave - Tabelë kontrolluese e mençur e qytetit <u>Qëllimi:</u> Futja dhe shfrytëzimi i teknologjive të përparuara digjitale, në aspekte të ndryshme, në nivel të Qytetit të Shkupit, në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët.			
--	--	---	--	--	--



		<u>Grupet e synuara/bartës:</u> Të gjithë qytetarët e Qytetit të Shkupit Qyteti i Shkupit			
2. Ndërtimi i infrastrukturës për kompleksin SMARTSITYnë Panairin e Shkupit		<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Qytet i mençur- modernizim i qytetit</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Realizimi i projektit për ndërtimin e infrastrukturës për kompleksin SMARTSITYnë Panairin e Shkupit. SMARTSITYdo të ndërtohet në formë të mini qytetit, në të cilin do të jenë të përfshirë hotele, objekte banimi dhe qendër tregtare. <u>Qëllimi:</u> Ndërtimi i kompleksit modern afarist, banesor dhe hotelerik. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Qytetarë të Qytetit të Shkupit Qyteti i Shkupit (60%) Komuna Gazi Baba (40%)	Vitet 2019 – 2021	Rritja e potencialit afarist, banesor dhe turistik të Qytetit të Shkupit	3.000.000 EUR (2019 – 2021) Nga 1.000.000 EURnë vit
3. Komuna miqësore të biznesit		<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Ambient i volitshëm afarist</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Vendosja e masave stimuluese në formë të granteve, subvencioneve, kreditimit etj., ndërsa në drejtim të motivimit të komunave të Qytetit të Shkupit për miratimin e standardeve dhe kriterëve për komuna miqësore të biznesit.	Mesi i vitit 2019	Numër i shtuar i komunave në Qytetin e Shkupit të standardizuara me sukses për komuna miqësore të biznesit. Rritje e zhvillimit ekonomik të ekonomive lokale	



		<u>Qëllimi:</u> Përparimi i kushteve për të bërë biznes në nivel lokal në drejtim të rritjes së zhvillimit ekonomik të ekonomive lokale dhe tërheqjes së investimeve të reja. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Qytetarë Komuna në Qytetin e Shkupit Qyteti i Shkupit		Tërheqje e investimeve të reja dhe hapje e bizneseve të reja në nivel lokal	
4. Administratë e qytetit dhe ndërmarrje publike funksionale		<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Ambient i volitshëm afarist</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Me realizimin e projektit “Qytet i mençur”, Shkupi do të bëhet kryeqendër moderne, ku forcë themelore lëvizëse janë teknologjitë e përparuara informatike, me çka edhe vetë administrata e qytetit do të jetë më funksionale dhe do të përparohet lidhja midis ndërmarrjeve publike me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët. Do të mundësohet grumbullimi sistemor i informatave të dobishme, të centralizuara, të disponueshme dhe të dobishme për çdo qytetar. <u>Qëllimi:</u> Sigurimi i shërbimeve publike efikase dhe efektive, që do të kenë njohuri të plotë për performancat e administratës së qytetit. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Qytetarë	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Sigurimi i shërbimeve më të mira për qytetarët	



		Qyteti i Shkupit Ndërmarrje publike			
5. Forume dhe debate publike në nivel të qytetit të Shkupit, komunave, sektorëve		<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe standardit jetësor të qytetarëve</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Të vendoset praktikë e rregullt, që në vazhdimësi të organizohen forume dhe debate publike në nivel të qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit. Këta debate mund të jenë tematike dhe të mbulojnë sektorë dhe fusha të veçanta rreth të cilave do të diskutohet, do të këmbëhen qëndrime dhe mendime në drejtim të përcaktimit të nevojave dhe masave konkrete për zhvillimin lokal ekonomik. <u>Qëllimi:</u> Organizimi i forumeve dhe debateve publike, në drejtim të përcaktimit të nevojave dhe masave konkrete për zhvillimin lokal ekonomik, nga sektorë/fusha të ndryshme. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Qytetarë Qyteti i Shkupit Komunat e Qytetit të Shkupit	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Pasqyrë më e mirë e nevojave të bashkësisë lokale Komunikim i papenguar me të gjithë aktorët me ndikim në drejtim të krijimit të nevojave specifike dhe masave për zhvillimin ekonomik lokal, nga sektorë / fusha të ndryshme.	
6. "Qendër e bashkësisë së komunave"		<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe standardit jetësor të qytetarëve</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Përfshirja aktive e qytetarëve në përgatitjen	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Model i ri i vetëqeverisjes lokale të hapur dhe shërbyese për të gjithë	



		dhe miratimin e politikave lokale, përmes qasjes së hapur në vetëqeverisjen lokale, që të mundet çdo qytetar të japë propozime dhe mendime konkrete. <u>Qëllimi:</u> Përfshirja e qytetarëve në krijimin e politikave lokale, me çka ato do të përpunohen dhe zbatohen, në përputhje me nevojat dhe pritjet reale të qytetarëve. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Qytetarë Qyteti i Shkupit Komunat e Qytetit të Shkupit		Krijimi dhe zbatimi i politikave lokale, në përputhje me nevojat reale dhe pritjet e qytetarëve	
7. Zhvillim i bashkëpunimit ndërkomunal dhe krijim i politikës kulturore për bashkëpunim ndërkomunal		<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Ambient i volitshëm afarist</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Bashkëpunimi ndërkomunal përfshin dy ose më shumë komuna fqinje të cilat punojnë së bashku për të kryer detyra administrative të komunës, për t'u dhënë shërbime publike qytetarëve dhe për të nxitur zhvillimin lokal përmes kryerjes më efikase dhe më ekonomike të kompetencave të komunave, të përcaktuara me ligj, dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta. Vetëdijësimi i komunave për nevojën dhe leverditë e bashkëpunimit ndërkomunal. <u>Qëllimi:</u> Përparimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe	Në vazhdimësi deri në vitin 2021	Kryerje më efikase dhe më ekonomike të kompetencave të komunave Sigurimi i shërbimeve më të mira për qytetarët	

		krijimi i politikës kulturore për bashkëpunim ndërkomunal, në drejtim të kryerjes më efikase dhe më ekonomike të kompetencave të komunave. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Qytetarë Qyteti i Shkupit Komunat e Qytetit të Shkupit			
8. Gazifikimi i qytetit të Shkupit (rrjeti sekondar)		<u>Qëllimi strategjik:</u> <u>Energjetika dhe efikasiteti energjetik</u> <u>Përshkrim i shkurtër:</u> Shkupi, në periudhën e dimrit, është qytet me ndotje enorme, me ndotje disa herë më të lartë se sasia e lejuar. Kjo posaçërisht ndodh për faktin që një numër i madh amvisërishtë dhe kapacitetesh ekonomike, për ngrohjen e objekteve, përdorin dru për ngrohje, naftë, goma, plastikë e tjerë. Lidhja e shtëpive me gazsjellësin e qytetit do ta zvogëlojë përdorimin e lëndëve djegëse që e ndotin ambientin jetësor. Plani i gazifikimit të Qytetit të Shkupit përfshin: - Kompletimi i ndërtimit të rrjetit primar gazpërçues në pjesën perëndimore të Qytetit të Shkupit - Ndërtimi i rrjetit sekondar gazpërçues, me përparësi për vendbanimet e qytetit të cilat nuk janë të lidhura në sistemin qendror të ngrohtores.	Fundi i vitit 2019	Kursimi i energjisë elektrike Paksimi i ndotjes në Qytetin e Shkupit	



		<u>Qëllimi:</u> Zvogëlimi i përdorimit të lëndëve për ngrohje të cilat e ndotin ambientin jetësor, e me këtë edhe do të zvogëlohet ndotja e Qytetit të Shkupit, përmes kyçjes së amvisërive dhe kapaciteteve ekonomike në rrjetin e gazsjellësit. <u>Grupe të synuara/bartës:</u> Qytetarë Qyteti i Shkupit			
